

Raporti  
Vjetor  
2018

NLB Banka  
Prishtina

# Përzgjedhja rajonale





# Përzgjedhja rajonale

Raporti Vjetor 2018

NLB Banka Prishtina

# Përmbajtja

<b>Të dhënat kryesore financiare</b>	<b>6</b>
Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës	10
Mjedisi makroekonomik dhe zhvillimi i tregut	14
Strategjia	16
Rezultatet Financiare	18
Aktivitetet sipas segmenteve afariste	26
Afarizmi me persona juridik	26
Afarizmi me persona fizik	28
Tregjet financiare dhe operimet me pagesat	32
Teknologjia Informativë	34
Menaxhimi i Riskut	36
Përgjegjësia sociale e korporatës	37
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	39
Qeverisja Korporative	42
Auditimi i brendshëm	46
Spektori për pajtueshmëri dhe Integritet	47
Spektori për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe Financimin e Terrorizmit (PSHP/FT)	48
<b>Pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditorit</b>	<b>50</b>



# Të dhënat kryesore financiare

Tabela 1: Të dhënat financiare të NLB Banka sh.a. Prishtina

	2018	2017	2018/2017
<b>Pasqyra e të hyrave (në EUR mijra)</b>			
<b>Neto të hyrat</b>	32,407	29,081	11.4%
Neto të hyrat kamatore	27,371	24,469	11.9%
Neto të hyrat jokamatore	5,036	4,612	9.2%
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	-11,800	-11,241	5.0%
Shpenzimet e punonjësve	-5,960	-5,652	5.4%
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	-4,661	-4,442	4.9%
Zhvlerësimi	-1,179	-1,147	2.8%
<b>Fitimi para provizioneve</b>	20,607	17,840	15.5%
Përmirësimi i vlerave dhe provizioneve neto	-3,793	-2,176	74.3%
<b>Fitimi para tatimit</b>	16,814	15,664	7.3%
Tatimi	-1,977	-1,469	34.6%
<b>Fitimi pas tatimit</b>	14,837	14,195	4.5%
<b>Bilanci i gjendjes</b>			
Gjithsej asetet	668,127	584,086	14.4%
Kreditë e sektorit jo-bankar (neto)	466,854	386,804	20.7%
Kreditë e sektorit jo-bankar (bruto)	493,949	414,414	19.2%
Depozita e sektorit jo-bankar	585,861	506,671	15.6%
Gjithsej kapitali	71,787	66,704	7.6%
ROE pas tatimit	21.6%	22.2%	-0.6%
ROA pas tatimit	2.4%	2.6%	-0.3%
RORAC para tatimit	19.6%	22.4%	-2.8%
Raporti të hyra/shpenzime (CIR)	36.4%	38.7%	-2.2%
LTD (neto kreditë SJB /depozitat SJB)	79.7%	76.3%	3.3%
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit (BQK)	14.6%	15.9%	-1.3%
Kapitali i Klasit 1	13.4%	14.9%	-1.4%
Marzha e interesit	4.4%	4.9%	-0.5%

	2018	2017	2018/2017
<b>Kualiteti i portfolios dhe provizionet</b>			
Bruto kreditë jo-performuese	14,361	14,804	-3.0%
Raporti i KJP me gjithsej kreditë (Bankat +SJB)	2.7%	3.3%	-0.6%
Raporti i KJP të SJB	2.9%	3.6%	-0.7%
Kosto e riskut – neto (bps)	89	54	64.8%
<b>Treguesit tjere afarist</b>			
Pjesëmarrja në treg me gjithsej asete	16.8%	15.7%	1.1%
Pjesëmarrja në treg me Kreditë e SJB	17.7%	16.5%	1.2%
Pjesëmarrja në treg me Depozitat	17.7%	16.4%	1.4%
Numri i njësive afariste	38	44	-13.6%
Numri i bankomateve	66	68	-2.9%
Numri i klientëve aktiv	202,632	200,497	1.1%
Numri i të punësuarve	476	481	-1.0%

Shumat janë të prezantuara sipas inteksit

Përqindjet janë të prezantuara sipas diferencës







# Përzgjedhja rajonale

## Kapitulli 1

# Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Gjatë vitit 2018 kemi vazhduar me performancën tonë të shkëlqyer, duke arritur rezultate të qëndrueshme financiare në drejtim të objektivave tona të larta. Ne vazhdojmë të rritemi me përgjegjësi, duke shënuar një vit tjetër financiar të jashtëzakonshëm në historinë tonë 11 vjeçare, ndërkohë që vazhdojmë të qëndrojmë të përqendruar ndaj klientëve dhe objektivave afatgjata të aksionarëve tanë.

Viti 2018 ishte një tjetër arritje e shkëlqyeshme për NLB Banka, përmes përkushtimit të vazhdueshëm ne kemi arritur rritje rekorde të aseteve dhe profitabilitetit që nga themelimi i Bankës. Pavarësisht mjedisit delikat ekonomik për shkak të reagimit tonë adekuat, jemi të fokusuar në krijimin e vlerës afatgjatë si faktori ynë kryesor i suksesit.

Gjatë vitit 2018 kemi vazhduar rrugëtimin tonë duke forcuar themelet e rrugës sonë si një institucion financiar fleksibil me një prezencë të fortë në treg. Performanca jonë ka shënuar një rritje të vazhdueshme të aseteve të ndjekura nga rritja e të hyrave dhe profitabilitetit, që është mbështetur nga një sistem efikas i menaxhimit të riskut ndërkohë që është përmirësuar më tej procesi i menaxhimit të shpenzimeve. Si një nga parimet tona strategjike, rritja e përgjegjshme na mundësoi që të tejkalojmë sfidat në një ambient tejet konkurrues,

ndërkohë që mbetemi të qëndrueshëm drejt cikleve ekonomike, si një nga kredidhënësit më të mëdhenj në treg. Me qasjen tonë drejt së ardhmes, ku produktet e shërbimit financiar përfshijnë aspekte të ndryshme, ne mbetëm të përkushtuar ndaj përsosshmërisë operacionale si një nga gurët themelorë të së ardhmes sonë.

Duke qenë pjesë e një grupi të madh, stabil dhe profitabil siç është Grupi NLB, nënkuptohet njohje dhe besim i lartë nga klientët. Përkundër cikleve ekonomike brenda një tregu në zhvillim, me një ambient ekonomik delikat, konkurrenca në tregun financiar u zhvillua fuqishëm gjatë vitit 2018. Strategjia jonë i mundësoi bankës të mbetet një nga tre institucionet financiare më të mëdha dhe më të rëndësishme në tregun bankar të Kosovës.


Pikat kyçe do të përmbledhen shkurtimisht si në vijim:

- Realizimi i neto fitimit në vlerë prej 14.8 milion euro që paraqet 29% tejkalim të planit vjetor;
- Neto kreditë e sektorit jo-bankar sipas 31.12.2018 kanë arritur në 467 milion euro, që paraqet rritje për 81 milion euro ose 21% krahasuar me vitin 2017;
- Efikasiteti i kostos është përmirësuar më tej siç tregohet nga raporti i të hyrave dhe shpenzimeve prej 36.4%, i cili ka shënuar rënie nga 38.7% sa ishte në

vitin 2017;

- Kreditë joperformuese kanë shënuar rënie nga 3.6% në 2.9% të gjithsej kredive.
- Optimizimi i proceseve të brendshme është një proces i vazhdueshëm i cili mbështeti rezultatet e vitit aktual duke synuar avancimin operacional.

Avantazhi ynë në të kuptuarit e mjedisit me ndryshim të shpejtë dhe divergjencat e klientëve na mundëson që të rritemi duke pranuar dhe menaxhuar risqet që ndërliidhen me to. Strategjia bazë e Bankës mbetet të jetë një bankë e thjeshtë, por duke iu përgjigjur mjedisit në ndryshim të shpejtë dhe nevojave të klientëve nëpërmjet përsosshmërisë operacionale.



Albert Lumezi

Kryetar i Bordit Udhëheqës të Bankës



*Albert Lumezi*

Kyretar i Bordit Udhëheqës të Bankës

Lavdim Koshutova

Anëtar i Bordit Udhëheqës të Bankës



Bogdan Podlesnik

Anëtar i Bordit Udhëheqës të Bankës



## Kapitulli 2

# Mjedisi makroekonomik dhe zhvillimi i tregut

Gjatë vitit 2018, ekonomia e Kosovës ka vazhduar të shënojë norma pozitive të rritjes ekonomike. Burimet kryesore të financimit të rritjes ekonomike janë mbuluar nga rritja e investimeve dhe burimeve të brendshme si kreditimi bankar dhe shpenzimet publike.

Rritja është moderuar ndjeshëm pjesërisht për shkak të rënies së eksporteve dhe pjesërisht për shkak të zvogëlimit të konsumit qeveritar. Nga ana tjetër, një rritje e konsumit të ekonomive familjare në sajë të rritjes së remitancave, turizmit dhe rritjes së pagave kontribuoi në një rritje të solide të BPV-së në vitin 2018.

Edhe pse rritja ekonomike e Kosovës ka tejkaluar fqinjët e saj dhe Kosova është një nga katër vendet në Evropë që përjeton rritje në çdo vit që nga fillimi i krizës financiare globale në 2008 duke shënuar 4% të BPV -së, kjo rritje nuk është e mjaftueshme për të reduktuar ndjeshëm shkallën e lartë e papunësisë; të ofrojë vende pune, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë; ose të ndryshojë trendin e migrimit në shkallë të gjerë. Përkundër kësaj situatë, sektori bankar ka ruajtur likuiditetin, ka rritur profitabilitetin dhe ka forcuar stabilitetin e saj duke mbajtur në nivel të lartë mjaftueshmërinë e kapitalit.

Modeli i rritjes mbështetet kryesisht në remitancat nga diaspora, e cila vazhdon të jetë një burim kryesor financiar për familjet në Kosovë.

Norma e inflacionit u karakterizua me një rritje duke arritur në 1.1%, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që pozicioni fiskal mbeti stabil me normë të ulët të deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

Në fund të vitit 2018, Qeveria e Kosovës paraqiti masa mbrojtëse dhe vendosi tarifa shtesë mbi importet nga Serbia dhe Bosna. Ky veprim shkaktoi reagime negative të bashkësisë ndërkombëtare dhe ndaloi negociatat me Serbinë dhe procesin e hyrjes në BE.

**Tabela 2: Rritja reale e BPV dhe remitancave (mesatarja e periudhës)**

Kosovë	2017	2018
BPV (rritja reale në %)	3.2	3.8
Inflacioni – mesatarja për vitin (në %)	1.5	1.1
Papunësia (në %)	30	29.6
Borxhi publik (% e BPV)	16.6	17

## Burimi: raportet e BQK dhe ASK

Borxhi publik arriti rreth 1,093 milion euro në dhjetor 2018, ose 17.1% të BPV-së. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm dhe rritjes së borxhit të brendshëm.

Tabela 3: Sektori bankar në Kosovë (indikatore kyç)

Banka	Periudha	Gjithsej mjetet 000 EUR	Kreditë e SJB 000 EUR	Depozitat 000 EUR	NPL %	ROE a.t. %	CAR %	CIR %
Sektori Bankar	31.12.2017	3,732,349	2,354,730	3,097,376	3.10%	21.30%	18.00%	43.20%
	31.12.2018	3,972,908	2,625,697	3,304,762	2.70%	20.20%	17.00%	41.50%
NLB Banka	31.12.2017	585,187	387,689	507,208	2.90%	22.20%	15.90%	38.70%
	31.12.2018	665,861	464,560	586,244	2.70%	21.60%	14.60%	36.40%

Gjatë vitit të kaluar bankat komerciale të Kosovës i angazhuan të gjitha kapacitetet e tyre në dispozicion për të rritur sektorin privat dhe financat e ekonomive familjare, në mënyrë që Kosova të mund të ketë rritje më të madhe ekonomike, dhe të rrisë punësimin në vend. Gjatë vitit 2018, sektori bankar në Kosovë ka aprovuar 1,367.1 milionë euro kredi, nga të cilat 816.4 milion janë për sektorin privat dhe 550.7 milion euro kredi familjare. 59.7% e të gjitha kredive të disbursuara u janë dhënë personave juridikë, duke vendosur kapitalin në dispozicion për zgjerimin e kapaciteteve të tyre dhe rritjen e punësimin. Sistemi bankar i Kosovës është një nga punëdhënësit më të mëdhenj në sektorin privat.

Sektori bankar në Kosovë përbëhet nga 10 banka në vitin 2018 (2017: 10). Gjithsej asetet e sektorit bankar më 31 dhjetor 2018 kanë vlerë prej 4 miliardë eurosh. Tetë banka me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë sektorin bankar dhe menaxhojnë 88.9% të totalit të aseteve. Në vitin 2018, sistemi bankar operoi me fitim të shëndoshë pasi tatimi arriti në 87 milionë euro bazuar në standardet vendore.

Bankat e Kosovës janë kapitalizuar mirë (brenda një raporti të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 17.0% më 31.12.2018), ndërsa NLB Banka ka mjaftueshmërinë e kapitalit në 14.6%.

Rritja e kreditimit në NLB Banka përfaqëson një model për grupin dhe rajonin me 19.8% rritje të kredive ndaj

SJB krahasuar me 31.12.2017. Rritja ishte më e lartë se sistemi total bankar i cili ishte 11.7%.

Depozitat nga SJB kane shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar me 15.6%, që paraqet rritje më të lartë se sektori bankar që ishte në 8.6%.

RKD (Raporti Depozit Kredi) është në trend të përmirësimit dhe sipas standardeve vendore është rritur në 79.2%, që është më e ulët se mesatarja e sektorit bankar (81.9%), ndërsa Kthimi në Equitet (pas tatimit) ka shënuar ulje në 21.6% krahasuar me një vit më parë (22.2%) dhe është mbi mesataren e tregut 20.2%, por me tendencë të qëndrueshme krahasuar me treguesit e tregut me luhatje më të larta në baza vjetore. Cilësia e investimeve bankare vazhdon të përmirësohet. Gjithsej kreditë jo-performuese në Kosovë arritën në 73.9 milionë euro, (2017: 76.5 milionë euro), dhe raporti i KJP është zvogeluar në 2.7% (2017: 3.1%).

Fokusimi në efikasitetin operacional dhe proceset e racionalizimit tregojnë për një CIR prej 36.4% për NLB Banka, e cila është më e mirë se e grupit prej 41.5%.

## Kapitulli 3

# Strategjia

## Misioni, Vlerat dhe Vizioni

NLB Banka vazhdon të ndjekë vizionin e saj për të qenë institucioni kryesor financiar i sektorit financiar në Kosovë, me një zhvillim të qëndrueshëm, ruajtjen e cilësisë së lartë të portofolios kreditore, stabilitetin financiar, duke dhënë rezultate të vazhdueshme dhe kontribuar në shoqëri.

Banka është e fokusuar në sigurimin e një niveli më të lartë të cilësisë së shërbimit dhe futjen e produkteve të reja moderne. Ne do të arrijmë këtë duke u fokusuar në nevojat e klientëve tonë dhe shoqërisë që i shërbejmë, duke dhënë në këtë mënyrë vlerë të qëndrueshme afatgjatë për të gjithë akterët tonë.

Banka do të vazhdojë të zbatojë vlerat vijuese të korporatës brenda dhe jashtë bankës:

- Përgjegjësia dhe llogaridhënia ndaj klientëve, të punësuarve dhe mjedisit shoqëror
- Përkushtimi për të përmbushur premtimet dhe objektivat tona
- Moderne, inovative dhe profesionale
- Komunikimi dhe bashkëpunimi i hapur
- Përfitimi i ndërsjellë,
- Efikasitet në përmbushjen e zotimeve tona.

Strategjia e re e NLB Banka adreson mundësitë për të rritur zhvillimin dhe për të përmirësuar profitabilitetin e veprimtarive të saj. Strategjia e re paraqet një portfolio të iniciativave strategjike me ndikim afatshkurtër dhe afatmesëm, i cili do të modernizojë dhe përmirësojë operacionet e tij, do të rrisë të ardhurat, zvogëlojë shpenzimet dhe do të përmirësojë perspektivat e saj të rritjes.

Prioritetet kryesore të strategjisë sonë mbeten si në vijim:

- Zgjidhje inovative që adresojnë nevojat e klientëve (shpërndarja/distribucioni shumë-kanalësh zgjidhjet gjithëpërfshirëse, dhe programet e partneritetit)
- Thjeshtësia (produkte të thjeshta dhe të kuptueshme, procese të shpejta dhe me kosto të ulët, prokurim efektiv, digjitalizim, etj)
- Fokus vendor (përforcimi dhe forcimi i pozicionit strategjik)
- Banking i mençur (përqendrimi në shërbimet këshilluese më shumë se sa në shërbimet transaksionale nga degët, përmirësimi i proceseve të shitjes)
- Matja e riskut (përmirësimi i proceseve të kreditimit, menaxhimi i riskut, modelimi dhe arkëtimet)
- Punonjësit e angazhuar (nxitjen e bashkëpunimit dhe angazhimin e mjedisit të punës, iniciativat për

përmirësimin e shkathtësive dhe aftësive, etj.).

- Urë midis tregut kosovar dhe tregjeve ku Grupi NLB është i pranishëm.

Me synimin për të zbatuar strategjinë e re, fokusi i Bankës do të jetë të qëndrojë pranë klientëve duke ofruar shërbime financiare të besueshme, inovative, miqësore me klientët, duke shfrytëzuar teknologji të reja dhe duke u fokusuar vazhdimisht në përmirësimin e produktivitetit; duke menaxhuar me efikasitet burimet e brendshme gjatë gjithë fazave të zbatimit, duke zhvilluar stafin dhe duke marrë ekspertizën e nevojshme për tu zgjeruar në nivel lokal dhe rajonal.

Jemi të përkushtuar në zhvillimin e një kulture të fokusit ndaj klientit, ndërgjegjësimit ndaj riskut, integritetit, proceseve efikase dhe përgjegjësive sociale. Duke respektuar besimin reciprok të klientëve tanë, punonjësve, aksionarëve dhe shoqërisë në të cilën punojmë na jep përgjegjësi të madhe. Duke i përfshirë vlerat tona në gjithçka që bëjmë, ne kemi fuqinë për të formësuar mjedisin tonë dhe për të kontribuar më tej në ndryshime pozitive.

Në afarizmin e saj kryesor NLB Banka do të dallojë në aspektin e të kuptuarit të klientit në thellësi, duke ofruar nivel të lartë të shërbimeve dhe kompetencës



këshilluese, me anë të qasjes së lehtë dhe shumëllojshmërisë së produkteve/kanaleve konkurruese.

NLB Banka do të fokusohet në përmirësimin e kënaqësisë dhe përvojës së klientëve në aspektin e digjitalizimit, zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të reja dhe inovative duke përdorur teknologjitë digjitale dhe mobile në mënyrë që të plotësojnë nevojat e një përdoruesi modern dhe të mjedisit në ndryshim.

NLB Banka do të jetë një bankë e qëndrueshme fitimprurëse, kryesisht duke punuar me klientët në segmentet kryesore të tregut ku mund të arrijë dhe të mbajë pozitën në mesin e tre konkurrentëve më të mëdhenj në aspektin e profitabilitetit (relativ) dhe pjesëmarrjes në treg.

#### Objektivat afat-mesëm

Banka ka përcaktuar objektivat financiare afatmesme vijuese si pjesë e planit të saj pesëvjeçar për vitet 2019 deri në vitin 2023:

- neto marzha kamatore ~ 4%
- raporti kredi/depozitë < 95%
- gjithsejt indikator i kapitalit, përafërsisht 15%
- raporti i të hyrave ndaj shpenzimeve < 40%
- kostoja e riskut < 90 bps
- raporti i ekspozimeve joperformuese < 3%
- kthimi mesatar në kapita > 19%
- pagesa e dividendes ~ 70%

Ndër sfidat kryesore me të cilat Banka do të përballë gjatë viteve të ardhshme, është ruajtja e neto marxhinës aktuale të interesit, veçanërisht në segmentin e korporatave. Hiper likuiditeti i pranishëm në sektorin

bankar të Kosovës gjatë viteve të fundit, ka çuar në një rënie të shpejtë të marzhave të interesit. Situata aktuale me likuiditetin ka sjellë një qëndrim agresiv të konkurrencës të bankave më të mëdha, veçanërisht për ekspozimet e mëdha ndaj klientëve të korporatave me klasifikim të mirë kreditor. Një mënyrë për të kompensuar rezultatet e uljes së marzhave kamatore është rritja e kreditimit të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjeve individuale, të cilat megjithëse ulën normat e interesit, ende ofrojnë mundësi për marzha pak më të mira kamatore, se sa në segmentin e korporatave të mëdha.

Pagesa e dividendës nga Banka do të varet nga një numër faktorësh, duke përfshirë strukturën e kapitalit të Bankës, apetitin e riskut, fitimet, gjendjen financiare, kërkesat rregullatore, kushtet e përgjithshme ekonomike dhe afariste si dhe perspektivat e ardhshme.

## Kapitulli 4

# Rezultatet financiare

Në fund të vitit 2018 Banka ka tejkaluar objektivat e saj në të gjithë zërat kryesor. Rritje e rëndësishme është evidente në të gjitha fushat, duke përfshirë rritjen e kreditimit, depozitave, neto të hyrat operative, sidomos të tarifave dhe mbajtjen e parametrave të kërkuar të kapitalit dhe likuiditetit, si dhe treguesit e qëndrueshëm të cilësisë së aktivës.

Gjithsej asetet më 31.12.2018 kanë arritur në 668.1 milionë euro dhe që paraqet shumën më të madhe bilancore që nga themelimi i Bankës.

Banka ka performuar shumë mirë dhe ka arritur fitim neto në shumën prej 14.8 milionë euro. Gjithsej të hyrat, neto të hyrat kamatore dhe neto të hyrat jokamatore ishin mbi nivelin e vitit 2017,

kryesisht për shkak të rritjes së portofolios kreditorë, kartelave dhe operacioneve bankare elektronike. CIR ka vazhduar të shënojë rënie dhe ka arritur në 36.4% (2017: 38.7%) për shkak të rritjes së të hyrave të cilat kanë tejkaluar rritjen e kostove. Gjithsej asetet kanë shënuar rritje për 14.4%, kryesisht nga kreditë neto të sektorit jo-bankar të cilat kanë shënuar rritje për 21%. Shuma e depozitave nga sektori jobankar ka shënuar rritje për 16%.

Tabela 4: Pasqyra e bilancit të suksesit dhe të hyrat tjera gjithëpërfshirëse

Pasqyra e të hyrave (në EUR mijra)	2018	2017	2018/2017
Neto të hyrat	32,407	29,081	11.4%
Neto të hyrat kamatore	27,371	24,469	11.9%
a) Të hyrat kamatore	30,635	27,968	9.5%
b) Shpenzimet kamatore	-3,264	-3,499	-6.7%
Neto të hyrat jokamatore	5,036	4,612	9.2%
Neto pagesat dhe komisionet	6,132	5,454	12.4%
a) Të hyrat nga pagesat komisionet	7,827	6,772	15.6%
b) Shpenzimet për pagesat dhe komisionet	-1,695	-1,318	28.6%
2b) Diferencat e kursit të këmbimit valutor	31	-33	-193.9%
2c) Neto fitimi/humbja nga asetet financiare dhe detyrimet në dispozicion për shitje	344	288	19.4%
2d) Fitimet/humbjet tjera neto operative	-1,471	-1,097	34.1%
Gjithsej shpenzimet	-11,800	-11,241	5.0%
Shpenzimet e punonjësve	-5,960	-5,652	5.4%
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	-4,661	-4,442	4.9%
Zhvlerësimi	-1,179	-1,147	2.8%
Fitimi para provizioneve	20,607	17,840	15.5%
Përmirësimi i vlerave dhe provizioneve neto	-3,793	-2,176	74.3%
Fitimi para tatimit	16,814	15,664	7.3%
Tatimi	-1,977	-1,469	34.6%
Fitimi pas tatimit	14,837	14,195	4.5%


### Neto fitimi

Gjatë vitit 2018, NLB Banka ka arritur një profitabilitet më të lartë se në vitin 2017, kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave neto kamatore dhe të ardhurave nga komisionet, pavarësisht tendencës negative të uljes së normave aktive të interesit në treg. Fitimi neto ka arritur në 14.8 milion euro ose 4.5% më i lartë krahasuar me vitin paraprak.

Diferenca e fitimit neto sipas metodologjisë vendore dhe SNRF është 22 mijë euro për shkak të metodologjive të ndryshme të provizionit.

Fitimi para tatimit ka arritur në 16.8 milion euro dhe është 7.3% më i lartë se vitin paraprak.


Figura 1: Struktura e pasqyrës së të ardhurave 2017-2018



### Neto të hyrat kamatore

Neto të hyrat kamatore kanë arritur në 27.3 milion euro, dhe kanë shënuar rritje për 2.9 milionë euro ose 11.9%, kryesisht për shkak të rritjes së të hyrave kamatore si rezultat i rritjes së portofolios kreditore dhe shpenzimeve më të ulëta të kamatore. Të hyrat kamatore të bankës mbizotërohen nga të hyrat e krijuara nga kreditë dhe avanset për klientët, pavarësisht tendencës rënëse të normave të interesit. Të hyrat kamatore janë rritur si në segmentin e retail poashtu dhe në atë të korporatave, dhe një pjesë tjetër është si rezultat i rritjes së afarizmit me kartela.

Figura 2: Të hyrat/shpenzimet kamatore 2017-2018



### Neto të hyrat jo-kamatore


Neto të hyrat jo-kamatore kanë arritur në 5 milion euro, dhe kanë shënuar rritje për 0.4 milion euro, ose 9.2% krahasuar me vitin paraprak si rezultat i faktorëve në vijim:

- Të hyrat më të larta neto të tarifave dhe komisioneve për 12.4% kryesisht i atribuohen rritjes së të hyrave nga kartelat, bankomatet, POS-at dhe

transaksionet elektronike,

- Rritja e diferencave neto të këmbimit valutor, dhe
- Të hyrat nga shitja e AFS në tregun sekondar.

Figura 3: Të hyrat/shpenzimet jokamatore 2017-2018



### Neto të hyrat nga tarifafat dhe komisionet

Neto të hyrat nga tarifafat dhe komisionet në 2018 kanë arritur në 6.1 milion euro dhe krahasuar me fundin e vitit 2017 kanë shënuar rritje për 12.4%.

Të hyrat nga tarifafat dhe komisionet kanë shënuar rritje për 15.6%, për shkak të rritjes së vëllimit të aktiviteteve të kartelave si dhe për shkak të të ardhurave më të larta të realizuara nga shërbimet nga bankingu personal dhe tarifafat për pagesat ndërkombëtare.

Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve kanë shënuar rritje për 28.6% krahasuar me vitin 2017 për shkak të vëllimit më të lartë të aktiviteteve të kartelave.

### Shpenzimet

Gjithsej shpenzimet kanë arritur në 11.8 milionë euro, dhe janë për 0.6 milion euro ose 5% më të larta. Rritja më e madhe është regjistruar në shpenzimet që lidhen me kostot e teknologjisë, materialeve dhe shërbimeve.

Pavarësisht nga këto rritje, shpenzimet vazhdojnë të jenë një fokus i vëmendjes së menaxhmentit dhe janë optimizuar përmes operacioneve efektive duke përmirësuar proceset dhe kontrollet. Prandaj CIR-i ka arritur në 36.4%, që është më i ulët se në vitin paraprak për 2.2%, për shkak të tejkalimit të rritjes së të hyrave ndaj shpenzimeve, duke qenë gjithashtu më i ulëti në sektorin bankar në vend.

Shpenzimet e personelit kanë arritur në 5.9 milion euro dhe ishin më të larta se në vitin paraprak për 5.4%. Këto shpenzime ndërlidhen me paga dhe shpenzime për trajnime profesionale.

Kostot e amortizimit ishin rreth 1.1 milionë euro dhe ishin më të larta se në vitin paraprak për 2.8% për shkak të investimeve të reja në teknologji.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative kanë arritur në 4.6 milion euro, me një rritje të lehtë prej 4.9% duke pasur parasysh rritjen e afarizmit, të nxitur kryesisht nga shpenzimet më të larta të afarizmit me kartela, mirëmbajtjen e softuerëve të TI etj.

Figura 4: Shpenzimet operative 2017-2018





Figura 5: Struktura e shpenzimeve operative



**Provizionet dhe rezervat**

Ishin më të larta se në vitin paraprak për 74.3%. Rritja e tillë është nxitur pjesërisht si rezultat i rritjes së portofolios kreditore dhe një pjesë tjetër ishte si rezultat i zbatimit të kërkesave të SNRF 9, pasi që Banka ka filluar të krijojë rezerva edhe për ekspozime të tjera, si për letrat me vlerë, bilancet e parasë së gatshme, plasmanët dhe asetet tjera. Prandaj kosto e riskut ka shënuar rritje nga -54 në -89 pika bazike.

Shpenzimet për tatim kanë shënuar rritje si rezultat i fitimeve të larta krahasuar me vitin paraprak, përderisa norma tatimore prej 10% mbetet e njëjtë.

## Pasqyra e pozicionit financiar

Gjithsej asetet janë rritur për 84.1 milionë euro dhe kanë arritur në 668.1 milionë euro, kryesisht të nxitura nga rritja e vazhdueshme e kredive të korporatave.

Në anën tjetër, në vitin 2018 banka ishte gjithashtu mjaft e suksesshme në afarizmin kryesor, ku gjithsej bruto kreditë e SJB kanë arritur në 466.8 milion euro.

Pothuajse të gjithë zërat në bilancin e gjendjes lidhur me likuiditetin kanë shënuar rritje si rezultat i rritjes së depozitave avista.

**Tabela 5: Pasqyra e pozicionit financiar**

<b>Bilanci i gjendjes (000 EUR)</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018/2017</b>
Gjithsej asetet	668,127	584,086	14.4%
Paratë e gatshme dhe bilanci me BQK	103,663	83,592	24.0%
Depozitat/kreditë e bankave (neto)	20,123	35,289	-43.0%
Kreditë e sektorit jo-bankar (neto)	493,949	414,414	19.2%
Gjithsej zhvlerësimet për kreditë e SJB	-27,095	-27,610	-1.9%
Kreditë e sektorit jo-bankar (neto)	466,854	386,804	20.7%
Kreditë e korporatave (neto)	292,200	237,953	22.8%
Kreditë e retail (neto)	174,654	148,851	17.3%
Letrat me vlerë	64,733	65,228	-0.8%
Asetet fikse	11,529	12,127	-4.9%
Asetet tjera	1,225	1,046	17.1%
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>668,127</b>	<b>584,086</b>	<b>14.4%</b>
Depozitat e bankave	392	537	-27.0%
Huamarrjet (Leasing)	58	77	-24.7%
Depozitat e sektorit jo bankar	585,861	506,671	15.6%
Depozitat e personave fizik	421,014	374,328	12.5%
Depozitat e korporatave dhe qeverisë	164,847	132,343	24.6%
Detyrimet tjera	10,029	10,097	-0.7%
<b>Gjithsej kapitali aksionar</b>	<b>71,787</b>	<b>66,704</b>	<b>7.6%</b>
Kapitali	51,287	51,287	0.0%
Rezervat (përfshirë fitimin e mbajtur)	5,009	1,288	288.9%
Tjera	654	-66	-1090.9%
Fitimi/humbja për periudhën	14,837	14,195	4.5%
<b>Zërat kryesorë jashtëbilancor</b>	<b>42,006</b>	<b>40,433</b>	<b>3.9%</b>
Akreditivat dhe garancionet	25,483	24,097	5.8%
Kreditë e shlyera në jashtëbilancore	16,523	16,336	1.1%

Figura 6: Gjithsej asetet dhe struktura e asetëve





Figura 7: Pjesëmarrja në treg



Sipas të dhënave të datës 31.12.2018, NLB Banka mbetet banka e tretë më e madhe në Kosovë, me pjesëmarrje në treg në gjithsej asetet me 16.8%. Pjesëmarrja në treg me neto kredi dhe depozita ishte 17.7%.

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK ka arritur në 103.6 milion euro, dhe krahasuar me fundin e vitit 2017, ka shënuar rritje për 0.1 milion euro ose 0.1% si rezultat i rritjes së depozitave gjatë vitit. Për më tepër, bilancet e BQK-së janë rritur si rezultat i diversifikimit të fondeve likuide nga plasmanet në bankat e huaja në llogarinë e BQK-së, të shkaktuara nga ulja e limiteve të ekspozimeve dhe normave negative të interesit jashtë vendit.

Paraja e gatshme është mbi rezervën minimale të likuiditetit të kërkuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.


Plasmanet në bankat tjera (neto) kanë arritur në 20.1 milion euro. Krahasuar me 31.12.2017 ka shënuar rritje për 4.8 milion euro ose 31%.

Letrat me vlerë kanë arritur në 64.7 milion euro, krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rënie të lehtë për 0.5 milion euro ose 0.8%. Investimet në letrat me vlerë të Kosovës janë rritur brenda limiteve të miratuara nga CRD (Ekspozimi i lejuar ndaj institucioneve shtetërore) me qëllim që të shmanget norma negative e interesit në Bankën Qendrore mbi suficitin e shtuar të fondeve likuide. Pjesa më e madhe e letrave me vlerë janë plasuar në Letrat me Vlerë të thesarit të Qeverisë së Kosovës me afat maturimi 3, 6 dhe 12 mujor për Bono të thesarit, 2 dhe 3 vite obligacione, përveç një garancioni në Bono/obligacione amerikane me afat maturimi 6 mujor dhe investimet të letrave me vlerë të kapitalit në VISA.

Me angazhimin e lartë të Bankës, kreditë neto të sektorit jo-bankar kanë shënuar rritje për 80.1 milion euro ose 20.7% krahasuar me vitin paraprak, dhe kanë arritur shumën prej 466.8 milion euro. Rritje shumë e madhe e volumit është shfaqur në segmentin e korporatave për 54.2 milion euro, dhe kreditë neto të klientëve fizik kanë shënuar rritje për 25.8 milion euro të nxitur nga një angazhim i jashtëzakonshëm i stafit të shitjes, duke qenë më aktiv në treg dhe ndikimin pozitiv të fushatës së marketingut. Struktura e neto kredive e sektorit jo-bankar përbëhet prej 63% kredive të klientëve juridik dhe dhe 37% e kredive të klientëve fizik, portfolio e balancuar mirë dhe shpërndarje e koncentrimin të riskut.

Raporti i LTD (neto) të SJB ka shënuar rritje të vazhdueshme krahasuar me vitin e kaluar dhe është përmirësuar në 79.7% (2017: 76.3%), nxitur nga rritja e kredive dhe mbajtja e nivelit të depozitave në nivel adekuat dhe përmirësimi i kualitetit.

Figura 8: Neto kreditë e SJB



### Neto provizionet për humbjet

**nga kredite** - Banka ka vazhduar të ketë qasje konzervative për krijimin e rezervave dhe provizioneve për kredi. Shuma e provizioneve ka arritur shumë në 34.8 milion euro, që ka shënuar rritje në krahasim me vitin 2017 për 0.9% si rezultat i ndryshimit të metodologjisë të provizioneve sipas kërkesave të SNRF 9.

Pjesa strukturore e depozitave të klientëve ka vazhduar të rritet dhe përbën 88% të gjithëj financimit të Bankës. Depozitat e SJB kanë arritur në 585.8 milion euro,


krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rritje për 79.2 milion euro ose 15.6%. Struktura e depozitave përbëhet prej 73% depozitave të klientëve fizik dhe 26% të depozitave të klientëve juridik; pjesa e mbetur prej 1% janë depozitat e qeverisë.

### Kapitali aksionar

Banka ka vazhduar të jetë e mirë-kapitalizuar, duke ruajtur një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 14.6%, që është më i lartë se minimumi i kërkuar prej 12%. Sipas SNRF, kapitali aksionar ka arritur 71.7 milion euro, dhe krahasuar me vitin 2017 ka shënuar rritje për 5.1 milion euro si rezultat i fitimit neto më të lartë. Në vitin aktual, Banka ka shpërndarë si dividendë shumë prej 10.5 milion euro. Banka është në përputhje me rregulloren e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës sa i përket mjaftueshmërisë së kapitalit.

Më 28 mars 2019 është mbajtur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, ku u vendos shpërndarja e dividendëve, 50% e fitimit neto të vitit 2018 sipas rregulloreve të BQK-së (7.4 milionë euro).

Figura 9: Depozitat e SJB







## Kapitulli 5

# Aktivitetet sipas segmenteve afariste

## Afarizmi me persona juridik

### 17,136

Klientë ose 3.2% më shumë se në vitin 2017

### 14,066

debit dhe kredit kartela, të lëshuara për personat juridikë, 18% më shumë krahasuar me vitin 2017

### 6,688

përdorues të e-banking në segmentin e personave juridikë. Rritje e vazhdueshme e numrit të përdoruesve, me një rritje vjetore prej 15% në vitin 2018.

### 1,913

POS, rritje prej 32% në vitin 2018

Kërkesat drejtuar bankave, nga klientët e korporatave po ndryshojnë vazhdimisht. Banka vazhdon t'i përgjigjet këtyre ndryshimeve dhe vepron si një partner strategjik për klientët e saj. Afarizmi bankar me korporatat në të ardhmen do të jetë dixhital, proaktiv dhe mbi të gjitha i orientuar nga klienti. Kjo nënkupton njohjen në mënyrë të duhur të nevojave të klientëve tanë dhe të transformohen ato në zgjidhje të shpejta dhe të thjeshta.

Bazuar në parimet që janë përmendur më lart, Banka vazhdon të ruajë pozitën e saj si një nga bankat kryesore për të gjitha bizneset në Kosovë, pa marr parasysh madhësinë e tyre, duke ju shërbyer më shumë se 17,100 ndërmarrjeve në 38 degë dhe nën degë, duke u ofruar klientëve tanë produkte dhe shërbime të ndryshme financiare, duke përfshirë kreditimin,

shërbimet e pagesave, si edhe si biznesin dokumentar. Banka vazhdon të jetë një partner i besueshëm për të gjitha segmentet e ndërmarrjeve. Fokusi strategjik është rritja e mbështetjes së NVM-ve.

Aktivitetet afariste me personat juridikë përfaqësojnë pjesën më të madhe të aktiviteteve të Bankës dhe paraqesin një pjesë të lartë të rritjes totale. Ato përfshijnë kreditë afatshkurtra për nevojat aktuale, linjat kreditore, mbitërheqjet, kreditë afatgjata për financimin e projekteve investive, kreditë për ndërtimin e objekteve afariste, letër kreditë dhe garancionet, aktivitetet me depozita, shërbimet e transaksioneve të pagesave vendore dhe ndërkombëtare.

Tabela 6: Të dhënat kryesore/kyçe të aktiviteteve me persona juridik

	2018	2017	2018/2017
Kreditë e korporatave (neto)	292,200	237,953	22.8%
Depozitat e korporatave dhe qeverisë	164,847	132,343	24.6%
Numri i klientëve	17,136	16,609	3.2%
Numri i kartelave debitor	12,316	10,396	18.5%
Numri i kartelave kreditore	1,750	1,505	16.3%
Numri i E-banking	6,688	5,828	14.8%

Figura 10: Trendi i kredive & depozitave në afarizmin me persona juridik 2017-2018




Figura 11: Aktivitetet kryesore bankare me korporata





Figura 12: Struktura e kredive te reja te korporatave sipas produkteve



Gjatë vitit 2018 kemi nënshkruar Amendamentin e Marrëveshjes së Garancioneve me Fondin për Garantimin e Kredive të Kosovës duke rritur kufirin e ekspozimit prej pesëqind mijë euro (500,000 euro) deri në një milion euro (1,000,000 euro). Kemi nënshkruar një marrëveshje tjetër garancioni me KCGF duke përfshirë në fondin e garancisë dhe portofolion për kredi bujqësore për personat juridikë.

Pavarësisht nga konkurrenca e fortë, Banka ka ngritur pjesëmarrjen e tregut nga 16.2% që ishte në fund të vitit 2017, në 17.6% në fund të vitit 2018. Banka ka arritur rritjen më të madhe të portofolit kreditor të korporatave në treg, duke rritur kreditë e korporatave për 54.2 milion euro ose 22.8% krahasuar me fundin e vitit 2017. Rritje domethënëse kishte gjithashtu në depozitat e korporatave për 32.5 milion euro ose 24.5% krahasuar me fundin e vitit 2017, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave me afat më të gjatë nga ndërmarrje private dhe publike.

Banka gjithashtu ka siguruar optimizimin e profilit të riskut duke mbajtur një monitorim të afërt portofolion kreditorë duke u fokusuar në mënyrë qendrore në ruajtjen e një portofolio cilësore kreditorë. Të gjitha këto rezultate janë arritur në bazë të përparësive kyçe si më poshtë:

- Personel profesional dhe të specializuar, i përkushtuar plotësisht ndaj klientëve, nevojave dhe kërkesave të tyre;
- Platformë e-banking të lehtë për përdorim për t'u siguruar klientëve mundësinë e vazhdueshme të shërbimeve të Bankës, kurdo dhe kudo;
- Gamë të gjerë e produkteve financiare të mbështetura nga produkte fleksibile, të përshtatshme dhe shërbime profesionale;
- Ofertë të gjerë të produkteve për klientët e korporatave dhe fokus të rritur në segmentin e NVM-ve;
- Pozitë shumë e fortë dhe në rritje e sipër në kreditë e korporatave.

## Afarizmi me persona fizik

### 298,404

Klientë- persona fizikë, 6% më shumë krahasuar me vitin 2017

### 231,352

Debit dhe kredit kartela në përdorim nga klientë - persona fizikë, 16.7% më shumë krahasuar me vitin 2017.

### 15,401

E-banking shfytësues, klientë- persona fizikë, 21% më shumë krahasuar me vitin 2017

### 38

Degë / nëndegë në shërbim të klientëve, me një shtrirje në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Afarizmi me persona fizik gjatë vitit 2018 ka vazhduar trendin e zhvillimit dhe të suksesit, në përputhje me strategjinë dhe planin afarist të Bankës. Pozita e Bankës në treg renditet si një nga tri bankat më të mira në afarizmin me persona fizikë në treg.

Përveç veprimtarive të rregullta në lidhje me aktivitetet bankare me persona fizik, fokusi ynë kryesor vazhdon të jetë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në përputhje me standardet më të larta të Grupit NLB, siç janë iniciativat strategjike,

çmimet stimuluese, efikasitetin e shitjeve, përmirësimin e eksperiencës dixhitale të klientëve dhe një fokus në shërbime këshilluese në vend të shërbimeve të transaksioneve fizike nëpër degë, gjë që do të promovojë migrimin e klientëve në kanale dixhitale dhe në bankimin elektronik.

Nëpërmjet këtyre përpjekjeve dhe iniciativave të vazhdueshme, ne kemi arritur zgjerimin e bazës së klientëve të segmentit retail gjatë vitit 2018, si një parakusht dhe mundësi më e madhe për të rritur portofolin e kredive të segmentit retail dhe mbështetjen e planeve të investimeve, në mënyrë që klientët e bankës të mund të blejnë shtëpi dhe të ndërtojnë jetën e tyre dhe të zgjerojnë pasuritë e tyre familjare. Zgjerimi i bazës së klientëve rezultoi edhe me rritjen e portofolios se depozitave, të kartelave debitore dhe kreditore, përdoruesve të e-banking dhe arritjen e niveleve më të larta të kënaqësisë së klientëve, konfirmuar nga kompania e jashtme e pavarur në anketën e organizuar për matjen e kënaqësisë së klientëve.

**Rrjeti i degëve:** Banka është e pranishme në tërë territorin e Kosovës, është e organizuar në 9 rajonet më të mëdha të vendit, me gjithsej 38 degë dhe nën-degë. Profitabiliteti i rrjetit të degëve është proces që monitorohet nga afër. Nga gjithsej 66 bankomate, 34 prej tyre janë bankomate depozitor, që u mundëson klientëve jo

vetëm tërheqje, por edhe deponime të parave të tyre sipas sistemit 7/24. Këto bankomate janë të vendosura në të gjitha njësitë e Bankës, si dhe në vendet më të frekuentuara jashtë njësisë të Bankës. Në përputhje me standardet e NLB d.d., 35 degë dhe nën-degë janë rinovuar ndërsa është bërë përpjekje e madhe për të përmirësuar të gjitha shërbimet bankare dhe për t'i përshtatur produktet e ofruara me fokus në nevojat e klientëve për shërbime bankare të sigurta dhe moderne.

Janë ndërmarrë aktivitete me qëllim të ruajtjes së pjesëmarrjes së lartë të tregut, si dhe mbajtjen e cilësisë së portofolios kreditore nëpërmjet prezantimit të produkteve promovionale të kredive si dhe përfitimeve të reja nga produktet ekzistuese, duke optimizuar, thjeshtuar dhe shkurtuar proceset për miratimin e ekspozimeve kreditore.

**Produktet dhe shërbimet e reja – aktivitetet kryesore** –Banka në vitin 2018 ka lansuar produkte dhe shërbimet të reja dhe përmirësime të mëtejme për klientët e saj si në vijim:

- Lansimi i produkteve të sigurimit ku Banka vepron si ndërmjetës në shitjen e policave;
- Zbatimi i Projektit të Çmimeve për Retail dhe NV (ndërmarrje të vogla);

- Zbatimi i Projektit për Rritjen e Efikasitetit të Shitjes për Retail dhe NV;
- Zbatimi i tarifave për shërbimet e reja shtesë, si kontribut në mbledhjen e të hyrave jokamatore;
- Zbatimi i paketave të reja (paketa bazë) dhe fillimi i migrimit të disa tipeve të llogarive të klientëve;
- Implementimi i funksioneve të sigurisë për shërbimin e Mobile banking;
- Qasja sistematike shumë-kanalëshe të shitjes (filiali, qendra kontaktuese, kanalet elektronike, e-banking dhe bankomatet);
- Kontaktet e rregullta me klientët dhe arritja e marrëveshjeve me kompani të ndryshme për të financuar shitjet e tyre me kredi për persona fizikë;
- Fushatat e rregullta të marketingut (TV, radio, portale, rrjete sociale etj.) me qëllim mbështetjen e shitjeve;
- Fillimi i zhvillimit të projektit LOPA (Loan Originated Process Approval);
- Fillimi i zhvillimit të projektit për kreditë e pasiguruara.

Tabela 7: Të dhënat kryesore të aktiviteteve me persona fizik

	2018	2017	2018/2017
Kreditë e retail (neto)	174,654	148,851	17.3%
Depozitat nga retail	421,014	374,328	12.5%
Numri i klientëve	298,404	281,500	6.0%
Numri i kartelave debitor	209,706	178,730	17.3%
Numri i kartelave kreditore	21,646	19,477	11.1%
Numri i E-banking	15,401	12,700	21.3%

Figura 13: Trendi i kredive & depozitave në afarizmin me persona fizik 2017-2018





Figura 14: Aktivitetet kryesore bankare me persona fizik




Trajtimi profesional dhe kujdesi ndaj klientëve ka shënuar rritjen e besimit të klientëve në bankë. Gjatë vitit 2018, është rritur numri i klientëve të rinj për rreth: 17 mijë dhe janë lejuar 100 milion euro kredi të reja.

Krahasuar me vitin paraprak, kreditë e personave fizik, kanë shënuar rritje për 25.8 milion euro (neto) ose 17.3%. Banka ka arritur të përmirësojë pozitën në treg, është ngritur nga 17% në 17.9% pjesëmarrje në treg.

Rritja më e madhe e segmenteve të kredive në numër dhe në shumë është segmenti i kredive për banim, që përbën rreth 61.5% të gjithëj portfolios kreditore. Është e rëndësishme të theksohet që kualiteti i portfolios kreditore vazhdon të jetë i lartë. Në fund të vitit 2018 rreth 98% e gjithëj portfolios kreditore të personave fizik ka qenë në kategorinë "A".

Afarizmi me depozitat e personave fizikë mbetet një ndër aktivitetet themelore tradicionale të Bankës. Krahas uljes së normave të interesit, depozitat e personave fizikë në fund të vitit 2018 arritën në 421 milion euro dhe krahasuar me vitin 2017 ka shënuar rritje për 46.6 milion euro (rritje për 12.5%), kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave avista në fund të vitit 2018.

Figura 15: Struktura e kredive të reja te personave fizik sipas produkteve



### Kanalet moderne të shpërndarjes

Banka ka vazhduar të zgjerojë portfolion e produkteve elektronike, përmes kanaleve moderne të shpërndarjes. Kjo është mundësuar duke zhvilluar dhe avancuar shërbimet elektronike dhe sigurinë e tyre. Vlen të përmenden avancimet në shërbimin M-Klik, me futjen e mundësive për kontrollimin e funksioneve të sigurisë në transaksionet me kartela. Poashtu me zgjerimin e rrjetit të POS-ave dhe rritjen e numrit të partnerëve afarist – tregtarëve, tek të cilët janë të janë të vendosur POS-at, të cilët mundësojnë pagesa me këste, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të produkteve ekzistuese E-Klik, kartelave dhe shërbimeve të bankomateve.

Platforma M-Klik (Mobile Banking) e Bankës tani i ofron të gjithë përdoruesve të saj mundësinë për të kryer të gjitha aktivitetet e përditshme bankare, duke qenë në lëvizje, përmes pajisjeve të tyre të telefonisë mobile dhe me shpenzime dukshëm më të ulëta.

Si rezultat i zhvillimit të afarizmit elektronik, numri i transaksioneve dhe qarkullimi nga klientët duke përdorur kanalet moderne të shpërndarjes, dita ditës ka shënuar rritje të vazhdueshme.

## Tregjet financiare dhe operimet me pagesat

### Menaxhimi i aktivës dhe pasivës

Depozitat e klientëve fizik kanë mbetur burimi kryesor i qëndrueshëm i financimit për Bankën në vitin 2018.

Në mënyrë që ti përgjigjet mjedisit dinamik të çmimeve, Banka ka aplikuar çmime aktive, prandaj rregullisht ka rishikuar Politikën e saj të Çmimeve për depozitat e klientëve, kreditë dhe produktet e tjera jokamatore.


Gjatë vitit 2018 likuiditeti i tepërt i të gjithë sektorit bankar ka vazhduar të mbajë presion rënës në normat e interesit të kredive dhe depozitave të klientëve. Ndër sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar banka gjatë vitit 2018 ishte ruajtja e marzhës aktuale të interesit neto, veçanërisht në segmentin e korporatave. Likuiditeti i tepërt i pranishëm në sektorin bankar të Kosovës gjatë vitit të kaluar, ka sjellë në një rënie të shpejtë të marzhës së interesit. Sidoqoftë, përkundër presioneve konkurruese në tregun vendor, marzha e interesit më 31.12.2018 është realizuar sipas Planit afarist (4.2%).

### Menaxhimi i likuiditetit

Krahas rritjes së shpejtë të kredive gjatë vitit 2018, Banka ka vazhduar të mbajë nivele të mjaftueshme të mbikëqyrjes së likuiditetit dhe të ketë një pozitë të qëndrueshme likuiditeti të pavarur nga Banka amë. Në periudhën prej 1.1.-31.12.2018, mesatarja e përbushjes së rezervës së detyrueshme minimale të detyrueshme të Bankës prej 10%, u mbajt gjatë vitit në nivelin mesatar

prej 13.45%. Gjatë vitit, NLB Banka optimizoi rezervën e likuiditetit të saj nga aspekti RWA-së duke investuar në Bono të thesarit të SHBA.

Figura 16: Menaxhimi i likuiditetit



Në vitin 2018 Banka ka testuar mundësinë për të marrë fonde likuide shtesë duke përdorur instrumentet financiare afatshkurtra të huamarrjes dhe realizimin e transaksionit të riblerjes së parë të Letrave me Vlerë në Kosovë.

Edhe pse është rritur oreksi i investitorëve për blerjen e letrave me vlerë afatgjata vendore, viti 2018 shënoi një kurs kthimi në të hyrat nga Bono të thesarit të Kosovës dhe Bonde duke u ngritur lehtësisht deri në fund të vitit. Gjatë vitit 2018, Qeveria e Kosovës ka lëshuar për herë të parë një obligacion 10 vjeçar me indikatorin e mbulueshmërisë së ofertës mbi 1.

Gjatë vitit 2018, Banka zgjeroi rrjetin e bankave korrespondente duke hapur një llogari Nostro me një nga bankat evropiane të klasit të parë. Banka ishte në pajtueshmëri të plotë me limitet e ekspozimit kreditorë të përcaktuara me metodologjinë e analizës dhe klasifikimit kreditor bazuar në klasifikimin ekzistues kreditor nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit kreditor dhe metodologjinë e brendshme të Grupit NLB.



**Tregu i këmbimeve valutore dhe Sistemi i Pagesave**

NLB Banka është e vetmja bankë në Kosovë që ofron këmbime valutore në 9 (nëntë) valuta të huaja të tregtueshme – USD, CHF, GBP, NOK, SEK, AUD, CAD, HRK dhe DKK.

Në tregun ndërkombëtar të këmbimit valutor, gjatë vitit 2018 janë tregtuar mbi 7,279 (2017: 3,517) transaksione, që paraqet shumën prej më shumë se 158 milion euro (2017: 113 milion euro). Konvertimet më aktive të këmbimit valutor gjatë vitit ishin EUR/CHF, EUR/USD dhe EUR/GBP.

Gjatë vitit 2018, Banka ka automatizuar dhe zgjeruar disa procese pagesash – tarifat e pagesave ndërkombëtare, shërbimet e internetit për pagesat e shërbimeve dhe modulën masiv të pagesave të pagave, duke u ofruar kështu klientëve shërbime të shpejta dhe të besueshme të pagesave.

Qarkullimi është rritur për 16%; janë përpunuar gjithsej 57 mijë pagesa ndërkombëtare (2017: 49 mijë), si dhe një qarkullim total prej 938 milion euro (2017: 787 milion euro).

Në fushën e transaksioneve të pagesave të jashtme, në vitin 2018 janë procesuar më shumë se 2.1 milion pagesa, si dhe është shënuar një qarkullim prej 2.9 miliard euro (2017: 2.5 miliard euro, ose 13% më shumë se në vitin 2017).

**Biznesi Dokumentar**

Në vitin 2018 Banka është përzgjedhur përsëri nga BERZH si “Banka me aktivitet më të lartë në lëshimin e instrumenteve financiare në Kosovë për vitin 2017” për përdorimin e Programit të Lehtësimit të Tregtisë (TFP) të BERZH-it. Në kuadër të Programit, Banka ishte në gjendje të zgjeronte dhe përmirësonte ndihmën për klientët të cilët merren me import të mallrave në transaksionet e tyre ndërkombëtare tregtare duke lëshuar në emër të tyre të gjitha llojet e instrumenteve të nevojshme të biznesit dokumentar, si dhe për të bashkëpunuar me më shumë banka korrespondente dhe për të menaxhuar me lehtësi rezervën e zotuar të likuiditetit.


Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 është shënuar rritje në shumën totale dhe numrin e lëshuar të letër kredive për rreth 5.7 milionë euro, ndërsa qarkullimi total për vitin 2018 ishte 9.1 milionë euro.

Garancionet e lëshuara gjatë vitit 2018 arritën përafërsisht 19.5 milionë euro. Më shumë se dyzet për qind e qarkullimit të garancioneve përbëhet nga garancionet e pagesës, për një përqindje pak më të ulët nga garancionet e tenderit, dhe pjesa tjetër nga garancionet doganore dhe të performancës.

Krahasuar me vitin 2017, Banka në vitin 2018 ka rritur aktivitetin e saj në mbështetjen e klientëve të saj, në rolin e eksportuesve, për të ekzekutuar kontratat e tyre me partnerët ndërkombëtarë. Vlera e Letër kredive për eksport dhe lora garancioneve të pranuar nga Banka, për njoftim të mëtejshëm tek klientët e Bankës, gjatë vitit 2018 ka arritur vlerën totale prej EUR 1.7 milion.

Gjatë vitit 2018, Banka ka trefishuar qarkullimin në Llogarinë e Dorëzarisë duke nënshkruar disa marrëveshje të dorëzarisë në shumën totale prej 32.4 milion euro (2017: 8.5 milion euro).

**Figura 17: Portfolio e letër kredive dhe garancioneve**



■ Portfolio e letër kredive dhe garancioneve

## Teknologjia Informative

Gjatë vitit 2018, përveç mbështetjes së rregullt për operacionet afariste, janë zbatuar edhe një numër i projekteve të infrastrukturës dhe aplikacioneve në fushën e teknologjisë informative me qëllim të sigurimit të mbështetjes së duhur të TI-së për proceset afariste dhe iniciativat zhvillimore.

Për të siguruar rikthim efikas në raste fatkeqësish, divizioni i TI-së vazhdoi të ndjekë një proces të vazhdueshëm të rishqyrtimit të Planeve të Vazhdimësisë së afarizmit dhe Procedurave të Rikthimit (BCP) duke shqyrtuar dokumentet dhe kryerjen e testeve sipas planeve të vendosura në fillim të vit kalendarik. Përveç kësaj, Banka ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën e saj bazë duke përmirësuar infrastrukturën virtuale dhe duke migruar serverët kryesorë bankarë në infrastrukturën virtuale.

Strategjia e TI-së për periudhën 2017-2022 është ndryshuar në mënyrë që të reflektojë ndryshimet në planin dinamik të zbatimit të detyrave strategjike të zhvillimit dhe të theksojë rëndësinë e iniciativës strategjike të zbatimit të API Core.

Bordi i Drejtorëve ka aprovuar Politikën e Sigurisë së Rrjetit. Ky dokument është përgatitur në bazë të udhëzimeve të pranuar nga NLB d.d. dhe ka si qëllim rritjen e informatave/ sigurisë kibernetike.

Një fokus i veçantë i është dhënë implementimit të zgjidhjes me qëllim rritjen e sigurisë kibernetike të bankës. Në këtë drejtim, është krijuar Qendra e

Operacioneve të Sigurisë (SOC) dhe është implementuar zgjidhja e IBM QRadar Sigurinë e Informacionit dhe Menaxhimin e Eventeve (SIEM) .

Procesi i menaxhimit të dobësive në sistemin e informacionit është pjesë e përpjekjeve të Bankës për të kontrolluar risqet e sigurisë së informacionit. Në përputhje me këtë qasje, Banka ka zbatuar një zgjidhje për identifikim të dobësive potencialisht të eksploatueshme të sigurisë (Nessus) për të marrë një pasqyrë të vazhdueshme të dobësive në mjedisin e TI-së dhe risqet që lidhen me to.

TI ka marrë pjesë aktivisht në aktivitetet rajonale të Infrastrukturës së TI-së të Grupit NLB duke përfshirë aktivitetet në zgjidhjet strategjike dhe standardet në telekomunikim, qasjen e përbashkët ndaj licencimit të Microsoft-it, zgjidhjet strategjike dhe standardet për sigurinë e TI-së, etj. Në këtë drejtim, është kryer një numër aktivitetesh si iniciimi i RFP për zbatimin e zgjidhjes IDP / IPS bazuar në standardet e Grupit NLB, pjesëmarrja në përgatitjen e planit të infrastrukturës së rrjetit etj.

Disa procese të tjera afariste të mbështetura nga zhvillimi i brendshëm i TI-së, prej të cilave janë më të rëndësishmet zhvillimet e brendshme në Data Warehouse dhe interface të ri në mes të sistemit kryesor të Bankës dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) duke mundësuar raportimin periodik automatik të gjendjes së llogarisë rrjedhëse të klientëve në BQK.

TI ka mbështetur në mënyrë aktive implementimin e autorizimit të pagesave përmes Debitimit Direkt në Sistemin e Pagesave Ndërbankare (RTGS – Real Time Gross Settlement) bazuar në standardet ISO 20022, zbatimin e Aplikacionit të Kalkulimit të Provizioneve (PCA – Provision Calculation Application) bazuar në standardin IFRS9, IPM (Menaxhimi i Palëve të Përfshira) është testuar dhe përgatitur për implementimin në prodhim në vitin 2019.



## Kapitulli 6

# Menaxhimi i Riskut

Si një institucion financiar, banka është e ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve si pjesë e veprimtarisë së saj afariste. Kështu, menaxhimi i përgjegjshëm dhe efikas i riskut mundëson rritjen e shëndoshë dhe të qëndrueshme të bankës sonë. Duke pasur një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut, ne mbështetim në mënyrë efikase përmbushjen e nevojave të klientëve, duke dhënë vlera për aksionarin dhe palët e interesit.

Ne kemi një qasje gjithëpërfshirëse drejt menaxhimit të riskut, i cili artikullohet nëpërmjet strategjisë sonë të riskut dhe apetitit të riskut. Menaxhimi i fuqishëm i riskut është i përfshirë brenda aktiviteteve ditore të bankës, përmes një strukture organizative të qëndrueshme të mbështetur dhe udhëhequr nga një strategji e shëndoshë e menaxhimit të riskut, që siguron një pasqyrë të duhur dhe llogaridhënie brenda Bankës.

Prandaj, roli kryesor i menaxhimit të riskut është reflektimi dhe zbatimi i apetitit të riskut të NLB Banka sh.a, në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme, e cila fillon me kuptimin e specifikave të bankës dhe specifikave të tregut, me një objektiv të vetëm të ruajtjes dhe duke kontribuar në menaxhimin efektiv dhe efikas të riskut.

Një funksion i mirë i vendosur për menaxhimin e riskut që përfshin një strukturë të drejtorëve jo-ekzekutiv dhe

ekzekutiv mundëson qeverisjen e pavarur dhe efikase të riskut. Përdorimi i modelit me tri linja të mbrojtjes në menaxhimin e riskut është shtylla kryesore e strukturës qeverisëse të riskut të Bankës.

Aktivitetet e kreditimit si një nga aktivitetet kryesore të veprimtarisë së bankës ekspozon bankën ndaj riskut kreditor, dhe që është gjithashtu nxitësi kryesor i ekspozimit ndaj riskut kreditor. Prandaj, për të krijuar një qasje të kujdesshme ndaj menaxhimit të riskut, Banka ka përdorur praktika të përafërta me strategjinë e menaxhimit të riskut të Grupit NLB dhe rregulloret e BQK-së duke njohur specifikat lokale dhe dallimet në mjedisin e biznesit që mbizotërojnë në tregun e Kosovës. Një qasje e tillë mundësoi instalimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të riskut kreditor.

Risku operacional - Qëllimi i menaxhimit të riskut është të menaxhojë ekspozimin ndaj riskut operacional dhe të zvogëloj humbjet potenciale që mund të ndodhin për shkak të sistemeve të brendshme jo-adekuate, procesit të kontrollit, dobësive dhe dështimeve gjatë procesit të punës, aktiviteteve ilegale dhe ngjarjeve të jashtme të cilat mund shkaktojnë humbje për bankën. Për të mundësuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut banka ka krijuar strukturat e duhura (Komiteti i menaxhimit të riskut operacional) dhe ka caktuar përgjegjësitë në kuadër të

strukturës organizative të bankës për të siguruar identifikimin efikas të riskut, regjistrimin, zvogëlimin dhe monitorimin e riskut operacional. Ngjarjet e dëmshme që rrjedhin nga risku operacional janë përcjellë në baza mujore, në mënyrë aktive janë monitoruar dhe raportuar tek organet e brendshme të bankës.

Detajet për Menaxhimin e Riskut duke përfshirë riskun kreditor, riskun e likuiditetit, riskun e normës së interesit, riskun e menaxhimit të kapitalit, etj, janë paraqitur në shënimin (31) në Sektorin e menaxhimit të riskut të pasqyrave të audituara financiare.

## Kapitulli 7

# Përgjegjësia sociale e korporatës

## Aktivitetet sociale dhe mjedisore

Si pjesë e Grupit NLB dhe si Bankë që vepron në Kosovë, kemi një mision të rëndësishëm për shoqërinë dhe përgjegjësinë sociale për mjedisin në të cilin veprojmë, përveç që të arrijmë rezultate të mira financiare, ne gjithashtu kontribuojmë në një jetë cilësore për të gjithë qytetarët. Ne kemi një qëndrim të përgjegjshëm për aksionarët, punonjësit, klientët dhe gjithë shoqërinë.

Për të qenë më afër klientëve të saj, NLB Banka i ka përshtatur të gjitha shërbimet e saj klientëve të saj dhe vazhdon të jetë një derë e hapur dhe një mundësi e madhe në thjeshtimin e mënyrës së jetesës, duke i mbështetur ata në zhvillimin dhe përparimin e misionit dhe vizionit të tyre.

Ne vazhdojmë të mbështesim sportin dhe artin dhe jemi veçanërisht krenarë për pjesëmarrjen tonë tradicionale në shumë projekte humanitare që mbështesim bashkë me klientët dhe të punësuarit tanë.

### Aktivitetet e ndërmarrura në mbështetjen e klientëve/qytetarëve

- Ndihma për klientët - NLB Banka me punën e saj të përgjegjshme ka arritur të fitojë besimin e klientëve, duke u përpjekur që gjithmonë të japë këshilla bazuar në njohuritë, ekspertizën dhe përvojën për t'i ndihmuar ata të përgatiten për gjithçka që vijon.

- Me zhvillimin e shërbimeve moderne bankare, investimet dhe shërbimet e sigurimit, banka u ofron klientëve shërbimet që i përshtaten realitetit të tyre financiar, duke i ndihmuar ata të tejkalojnë sfidat dhe të bëjnë zgjidhjen e duhur për të ruajtur të ardhmen e tyre.

### Aktivitetet lidhur me solidaritetin humanitar

Gjatë vitit 2018 NLB Banka ka mbështetur kampanjat në vijim:

- Fushatën “Ti je një luledielli” me dhurimin e gjithsej 10,000 euro.
- Aktivitetin bamirës Aksioni për Nënën dhe Fëmijët të cilët kanë organizuar “Të vallëzojmë për Nënën dhe Fëmijët” me qëllim që të ndihmojnë nënën dhe fëmijët në nevojë.
- Donacion në Darken e Bamirësisë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, fondet e mbledhura nëpërmjet kësaj ngjarjeje do të përdoren për renovimin e ambientit në Spitalin Pediatrik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.
- Pjesëmarrja në turneun vjetor të Bamirësisë në Lojën Bowling të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane për mbledhjen e fondeve me qëllim të mbështetjes së qytetarëve kosovarë që kanë nevojë për procedurat dhe trajtimet mjekësore.

- Ekspozitën “Nëpërmjet fotografisë” të organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë me qëllim mbledhjen e fondeve për fëmijët pa kujdes prindëror dhe në rrezik.
- Organizimi i një dite zbatimë plot aktivitete për fëmijët në Istog me rastin e Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Sindromin Down.
- Donacion - kompjuterë për Organizatën e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës
- Donacion për përmirësimin e kushteve të jetesës në Institutin Special të Shëndetit Mendor në Shtime
- Kontributin në mini maratonën humanitare “Vrapo Babadimër” (Run Santa), projekt ky që siguroi ushqim dhe dhurata për fundin e vitit për 500 familje në nevojë në Kosovë.
- Donacion për dhuratat e Vitit të Ri për fëmijët për Shoqatën PEMA për Kujdesin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Ferizaj.
- Donacioni për dhuratat të Vitit të Ri për fëmijët e Organizatës Joqeveritare “Autizmi”

### KULTURA DHE MJEDISI

- **Kujdesi ndaj klientit** - Me miratimin e politikave dhe procedurave të kreditimit, Banka ka parandaluar financimin e projekteve të klientëve të cilët mund të rrezikojnë ndotjen e mjedisit. Banka gjithashtu i përmbahet këtyre kritereve në lidhje me linjat kreditore të cilat Banka merr nga institucionet financiare ndërkombëtare.
- Mbështetja financiare dhe pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve dhe Drurit.

### Aktivitetet kulturore dhe sportive

Gjatë vitit 2018 NLB Banka ka mbështetur aktivitetet e mëposhtme:

- Organizimi i garës së shahut në nder të Ditës së Çlirimit të Prishtinës, në bashkëpunim me Ambasadën e

Republikës së Sllovenisë, Klubin e shahut “Drejtësia” dhe Federatën e Shahut në Kosovë.

- Organizimi i Turneut Memorial të Shahut për nder të z. Mustafë Ibrahim, ish i punësuar i Bankës dhe ekonomist i mirënjohur.
- Pjesëmarrja në Turneun e Bamirësisë në Futboll të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane
- Sponsorimi i klubit të futbollit “Prishtina” dhe Klubit të basketbollit “Bashkimi” në Prizren.
- Pjesëmarrja në Lojërat Sportive të Grupit NLB në Moravske Toplice në Slloveni, duke fituar 1 medalje ari, 2 argjendi dhe 2 bronzi.
- Pjesëmarrja në Turneun e Bamirësisë në Futboll “John McCain” Organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

## Kapitulli 8

# Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Funksionimi dhe performanca e NLB Banka bazohet në një qasje moderne të zhvillimit të Burimeve Njerëzore, dhe të proceseve, të cilat janë ndër burimet themelore të avantazhit konkurrues dhe performancës së suksesshme, të reputacionit të NLB Bankës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke qenë se zhvillimi bazohet në nevojat e sotme dhe të ardhme, dhe përderisa dalin nga strategjia afariste, së bashku me vizionin, misionin, qëllimet, kulturën, vlerat dhe zhvillimin e planifikuar, Burimet Njerëzore dhe Organizimi janë funksion strategjik dhe rrjedhimisht partner i rëndësishëm që mbështet zbatimin e strategjisë dhe vlerëson të gjithë akterët e proceseve të BNJ, organizimit në Bankë.

Shërbimi për Burime Njerëzore dhe Organizim në NLB Banka përveç me aktivitetet me të cilat merret në baza ditore, për vitin 2018 vlen të potencohen këto:

- I. Aprovimi i Strategjisë së Zhvillimit të Burimeve Njerëzore dhe Organizim për 2018-2021;
- II. Matja e kulturës organizative;
- III. Menaxhimi i objektivave dhe talentëve-pjesëmarrja në takimin vjetor të talentëve të Grupit NLB në Slloveni
- IV. Trajnimet – Përdorimi i aplikacionit ECHO si një metodë efikase, lehtësisht e disponueshme dhe me kosto efektive të trajnimit elektronik, qëllimi i së

cilës është transferimi i njohurive dhe informatave tek grupet e mëdha të të punësuarve.

Trajnimet me temat më të rëndësishme gjatë vitit 2018 ishin si në vijim:

- Trajnimet e mbajtura nga Instituti i Lidershit nga Shqipëria në temën “Lidershipi në shekullin 21”.
- Trajnimet e mbajtura nga Qendrës Didaktike Irisoft nga Shqipëria në temën “Vetë-Motivimi dhe Motivimi i të punësuarve”.
- Trajnimi i mbajtur nga Trainerja transformuese nga kompania Beyond Limits

mbi temat e “Inteligjencës Emocionale dhe Komunikimit Efikas”; dhe

- 6 punëtorë në temën Leadership Brand në të cilën morën pjesë 60 të punësuar në pozita udhëheqëse.

- V. Mësimi për punë praktike - NLB Banka është e angazhuar të ndajë praktikatat më të mira bankare me të rinjtë përmes mësimit dhe punës praktike dhe atë duke nënshkruar marrëveshje me kolegje, si dhe studentë individualë për t’ju mundësuar studentëve për vijimin e mësimit dhe punës praktike në Bankë.

Figura 18: Struktura e të punësuarve 2018




Tabela 10: Struktura e të punësuarve sipas gjinisë, shkollimit dhe moshës

<b>Struktura sipas gjinisë</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018/2017</b>
Femra	271	269	0.7%

<b>Struktura sipas shkollimit</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018/2017</b>
Shkolla fillore	1	1	0.0%
Shkolla e mesme	170	185	-8.1%
Shkolla e lartë	23	24	-4.2%
Universitet	248	240	3.3%
Master dhe doktoraturë	34	31	9.7%

<b>Struktura sipas moshës</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018/2017</b>
Deri 30 vjeç	52	59	-11.9%
Nga 31 deri 40 vjeç	208	217	-4.1%
Nga 41 deri 50 vjeç	114	99	15.2%
Nga 51 deri 60 vjeç	78	78	0.0%
Mbi 60	24	28	-14.3%





Kapitulli 9

# Qeverisja Korporative

## Qeverisja Korporative dhe

## Organet Udhëheqëse


Banka ka një strukturë të qartë organizative që saktësisht përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Organeve të tjera

udhëheqëse, të punësuarit e tjerë, si dhe të linjave të kontrollit në kryerjen e detyrave të përditshme.

Struktura organizative e Bankës është si në vijim:



Skema Organizative e NLB Banka sh.a.



Organet kryesore të Bankës janë:

- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve,
- Bordi i Drejtorëve
- Komiteti i Auditimit
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut
- Bordi Udhëheqës i Bankës

### Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të Bankës organizohet dhe merr vendime në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, ku merr vendime në përputhje me ligjin. Aksionet nominale i përcaktojnë pronarëve të drejtën mbi pagesën e dividendës dhe të drejtën e votës në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve

Me 31.12.2018 (Kapitali i autorizuar aksionar i Bankës përbëhet nga 42,739 aksione të rregullta me vlerë nominale prej 1,200 EUR për aksion. Aksionari më i madh i Bankës është NLB d.d. me 81.21%, ndërsa të dhënat më të detajuara janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare të audituara në kuadër të këtij raporti.

Përgjegjësitë e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të Bankës janë të përcaktuara me Statutin e NLB Banka, të cilat janë gjithashtu në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga rregullatori.

Gjatë vitit 2018, janë mbajtur 3 Mbledhje të Përgjithshme të Aksionarëve. Mbledhja e rregullt është mbajtur më 30 mars 2018. Në takim ishin të pranishëm 92.28% të aksionarëve. Në këtë Mbledhje të Përgjithshme të Aksionarëve janë miratuar disa akte, ndër të cilat: Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2017, Plani afarist, caktimi i auditorit të jashtëm për vitin 2018 si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të NLB Banka sh.a.

Mbledhjet e jashtëzakonshme janë mbajtur në janar dhe dhjetor 2018 për shkak të ndryshimeve në strukturën e Bordit të Drejtorëve.

### Përbërja e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga aksionarët e Bankës, në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe është përgjegjës pos tjerash edhe për krijimin e politikave, duke përfshirë Politikën për menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bordi i Drejtorëve kryen detyrat në përputhje me dispozitat e ligjit mbi bankat dhe Statutin e Bankës.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2018 ka mbajtur 7 mbledhje.

Struktura e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Bankës më 31 dhjetor 2018, ishte si në vijim:

- Z. Andreas Burkhardt, kryesues
- Znj. Hedvika Usenik, zëvendës kryesuese
- Z. Andrej Baričič, anëtar
- Z. Abdylmenaf Bexheti, anëtar
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtare
- Z. Albert Lumezi, anëtar – Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB Banka sipas funksionit pa të drejtë vote.

### Komiteti i Auditimit

Anëtarët e Komitetit të Auditimit me datë 31 dhjetor 2018 ishin si në vijim:

- Z. Andrej Baričič, Kryetar i Komitetit të Auditimit
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtare e Komitetit të Auditimit
- Z. Borislav Atanasovski, anëtar i Komitetit të Auditimit

Komiteti i Auditimit është themeluar në bazë të Ligjit për bankat ndërsa puna dhe aktivitetet e saja janë përcaktuar në Rregulloren e Punës së Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit mban së paku një mbledhje në çdo tre muaj. Gjatë vitit 2018 janë mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje.

Fushat e mbuluara nga Komiteti i Auditimit janë: miratimi i raporteve të auditimit të brendshëm, vlerësimi i procedurave të auditimit, vlerësimi i kontrolleve të brendshme, rishikimi i raportit të pajtueshmërisë, rishikimi i performancës financiare të bankës, rishikimi i letër rekomandimit të auditorëve të jashtëm dhe pasqyrat financiare të audituara. Përveç kësaj, komiteti i auditimit gjithashtu bën njohjen, vlerësimin dhe miratimin e rekomandimeve dhe nxjerr vendime lidhur me dokumentet e rregullatorit të jashtëm.

### Komiteti i Riskut

Më datë 31 dhjetor 2018 anëtarët e Komitetit të Riskut ishin si në vijim:

- Z. Jure Peljhan, Kryesues (deri me 14 dhjetor 2018)
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtare
- Z. Abdylmenaf Bexheti, anëtar

Komiteti i Menaxhimit të Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për bankat dhe funksionon në bazë të Rregullores së brendshme të Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut.

Komiteti i menaxhimit të rrezikut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut. Në Komitet janë anëtarë tre drejtorë jo-ekzekutiv.

Komiteti i menaxhimit të riskut mban së paku një mbledhje në çdo tre muaj në mënyrë që të monitorojë ekspozimin ndaj riskut dhe menaxhimin e riskut të Bankës. Si i tillë, komiteti mbikëqyr fushën e riskut kreditor, riskut të tregut dhe riskun operacional, me qëllim të zbatimit efikas dhe efektiv të oreksit të administrimit të riskut dhe strategjisë së riskut të NLB Banka.

### **Përbërja e Bordit Menaxhues të Bankës**

Bordi Udhëheqës i Bankës, udhëheq, përfaqëson dhe vepron në emër të Bankës, në mënyrë të pavarur dhe me vetë-përgjegjësi, ashtu siç parashihet me Statutin e Bankës. Kryetari dhe anëtarët emërohen me mandat katër vjeçar me mundësi të rizgjedhjes, në përputhje me kushtet e përcaktuar me Ligji dhe Statutin e Bankës.

Bordi Udhëheqës i NLB Banka përbëhet nga:

- Z. Albert Lumezi, Kryetar i Bordit Udhëheqës,
- Z. Bogdan Podlesnik, anëtar i Bordit Udhëheqës dhe
- Z. Lavdim Koshutova, anëtar i Bordit Udhëheqës.

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të afarizmit të Bankës si dhe monitorimin e aktiviteteve të rregullta, brenda Bankës gjithashtu veprojnë këto Komitete:

- Komitetit për menaxhimin e Aktivës dhe Pasivës (ALCO - brenda komitetit ALCO është themeluar nën-komiteti i quajtur komiteti i çmimeve)
- Komiteti kreditor
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor
- Komiteti i sigurisë
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Operacional
- Komiteti i TI-së
- Komiteti për Punë të Personelit
- Komiteti i Prokurimit
- Komiteti i Marketingut.
- Komiteti i parandalimit të shpëlarjes së parave



## Kapitulli 10

# Auditimi i brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm në NLB Banka kryhet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm. Sektori i Auditimit të Brendshëm është funksion i pavarur në bankë që në aspektin funksional i raporton direkt Komitetit të Auditimit të Bordit të Drejtorëve të Bankës, ndërsa në mënyrë administrative i raporton një anëtar të Bordit Udhëheqës të Bankës. Objektivi kryesor i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të ofrojë siguri objektive dhe këshilluese me qëllim të shtimit të vlerës dhe përmirësimit të proceseve në Bankë. Kjo arrihet duke përdorur një qasje sistematike dhe profesionale për të vlerësuar dhe përmirësuar menaxhimin e riskut, sistemin e kontrollit të brendshëm, qeverisjen dhe efikasitetin e operacioneve të bankës. Auditimi i brendshëm jep një kontribut të rëndësishëm për Bankën për të përmbushur objektivat e saj strategjike dhe afariste dhe për të aplikuar praktikat më të mira bankare.

Metodologjia e punës së Auditimit të Brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloren për Auditimin e Brendshëm në NLB Banka Prishtinë dhe Metodologjinë e Auditimit

të Brendshëm, të cilat janë plotësisht në përputhje me standardet e Auditimit të Brendshëm në NLB d.d, praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit, si dhe ligjet dhe rregulloret e Kosovës lidhur me auditimin.

Auditimi i brendshëm funksionon dhe është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe me Kodin e Etikës së auditimit të brendshëm dhe Rregullat dhe Rregulloret e Kosovës.

Sektori i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga katër punonjës. Plani i Auditimit të Brendshëm 2018 u miratua nga Komiteti i Auditimit i Bankës. Gjetjet dhe rekomandimet në raportet e auditimit iu prezentohen së pari drejtorëve të njësisë organizative, që i nënshtrohen auditimit, dhe Bordit Udhëheqës. Pas kësaj, raportet e auditimit të brendshëm të kompletuara me të gjeturat e përmendura më lart dhe rekomandimet e dhëna, përcillen për aprovim tek Komiteti i Auditimit i Bankës, i cili mbahet në baza tremujore.

Përveç kësaj, Auditimi i Brendshëm rregullisht ka monitoruar implementimin e rekomandimeve të lëshuara nga Auditori i Jashtëm, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Sektori i Auditimit të Brendshëm. Statusi i rekomandimeve të hapura është raportuar në baza tremujore në Komitetin e Auditimit të Bordit të Drejtorëve, Auditimin e Brendshëm të NLB d.d dhe tek Bordin Udhëheqës i Bankës. Përveç statusit të rekomandimeve të hapura, Auditimi i Brendshëm raporton tek Auditimit i Brendshëm i NLB d.d gjithashtu lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme të raporteve të auditimit dhe të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të auditimit të kryera në nivel të grupit. Së fundmi, Auditimi i Brendshëm gjithashtu ofron raporte të auditimit të brendshëm për auditorët e jashtëm dhe palët e jashtme (policia, kompanitë e sigurimeve dhe rregullatori) me kërkesën e tyre.

## Kapitulli 11

# Sektori për pajtueshmëri dhe Integritet

Sektori për Pajtueshmëri dhe Integritet gjatë vitit 2018, në koordinim dhe mbështetje nga NLB d.d. CSKPI, ka punuar në implementimin e rekomandimeve të ECRA, si dhe në përmbushjen e rekomandimeve nga vizita e rregulltë e cila është kryer nga NLB dd CSPKI - Ekzaminimi i zbatimit të standardeve të Pajtueshmërisë dhe Integritetit, dhe në plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mbrendshëm, gjithashtu.

Aktivitetet tjera me rëndësi të zhvilluara nga Sektori për Pajtueshmëri dhe Integritet:

- Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të pajtueshmërisë dhe integritetit (ECRA) - azhurnimi për vitin 2018. ECRA paraqet një pasqyrë të përgjithshme të risqeve të pajtueshmërisë dhe integritetit në bazë të së cilave identifikohen dhe vlerësohen risqet relevante në nivel të NLB Banka Prishtina.
- E-Anketa për çështjet e Pajtueshmërisë dhe Integritetit - me qëllim të krijimit të pikëpamjeve të punonjësve për situatën në Bankë në lidhje me pajtueshmërinë dhe etikën.
- Monitorimi i ndryshimeve në mjedisin ligjor. Avancimi i sistemit të monitorimit të ndryshimeve në mjedisin ligjor dhe vlerësimi i ndikimit në afarizëm, në bashkëpunim me njësitë tjera organizative.
- E-trajnimi dhe testimi mbi Pajtueshmërinë dhe Integritetin për të gjithë punonjësit e Bankës në temat: Etika dhe Integriteti; Parandalimi i konfliktit të interesit dhe korrupsionit; Parandalimi i sjelljes së keqe dhe sjelljes së dëmshme.
- Vlerësimet e pajtueshmërisë dhe raportimet.
- Mbështetja e njësive të tjera të biznesit duke dhënë opinione, këshillime dhe propozime në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme bankare.
- Dërgimi i informatave të rëndësishme për punonjësit rreth kodit të etikës, pajtueshmërisë dhe çështjeve të integritetit.

## Kapitulli 12

# Sektori për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe Financimin e Terrorizmit (PSHP/FT):

Banka është plotësisht në dijeni të kërkesave të PSHP/FT si në nivel lokal dhe ndërkombëtar dhe kupton rreziqet e SHP / FT. Në këtë drejtim, banka implementon politikën e tolerancës zero ndaj përdorimit të produkteve dhe shërbimeve tona bankare për qëllime të paligjshme. Sektori për PSHP/FT ka vazhduar me adaptimin e vazhdueshëm të politikave dhe procedurave në përputhje me kërkesat e reja ligjore për PSHP/FT dhe standardet e Grupit NLB, trajnimin dhe ndërgjegjësimin e të punësuarve në temat e caktuara, zhvillimi i kontrollave në njësitë organizative, implementimi i rekomandimeve. Në koordinim dhe mbështetje të CSKPI, aktivitetet tjera të rëndësishme:

- Në bashkëpunim me Divizionin e Pagesave implementimi i Projektit të aplikacionit për zbulimin e personave në listat e zeza dhe të sanksioneve ndërkombëtare " Safe Watch Filtering Project (SWF)",
- Themelimi i Komitetit të Produkteve të reja dhe ekzistuese - Zyrtari i AML-së është anëtar i përhershëm.
- Themelimi i Komitetit të AML-së.
- Miratimi i Politikave për zbatimin e masave kufizuese (sanksionet financiare dhe embargoja).
- Zbatimi i aplikacionit të ri - Moduli i Menaxhimit të Palëve të Përfshira (IPM) në mënyrë që të lehtësohet grumbullimi i të dhënave më cilësore bazuar në parimin "Njihet Klientin Tënd" - KYC.





Pasqyrat  
Financiare dhe  
Raporti i  
Auditorit

**NLB BANKA SH.A.**

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me  
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018**

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQE</b>
DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT	3
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	4
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	6
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	9
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	10 - 77

## DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT

### Për aksionarët dhe bordin e drejtorëve të NLB Banka sh.a.

Bordi Udhëheqës konfirmon përgjegjësinë e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, dhe për politikat që shoqërojnë kontabilitetin dhe shënimet e pasqyrave financiare.


Bordi Udhëheqës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Bankës më 31 dhjetor 2018, rezultatet financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar.

Bordi Udhëheqës gjithashtu konfirmon se politikat e duhura kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente dhe se vlerësimet e kontabilitetit janë përgatitur në përputhje me parimet e kujdesit dhe menaxhimit të mirë. Bordi udhëheqës më tej konfirmon se pasqyrat financiare të Bankës, së bashku me shënimet shpjeguese, janë përgatitur në përputhje me parimin e vazhdueshmërisë së operimit të biznesit dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Bordi Udhëheqës është gjithashtu përgjegjës për praktikatat e përshtatshme kontabël, për miratimin e masave të përshtatshme për ruajtjen e asetëve, dhe për parandalimin dhe identifikimin e mashtrimit dhe parregullsive të tjera ose aktiviteteve të paligjshme.

Prishtinë, Kosovë  
26 shkurt 2019

### Bordi Udhëheqës




---

Lavdim Koshutova  
Anëtar i Bordit Udhëheqës



---

Bogdan Podlesnik  
Anëtar i Bordit Udhëheqës



---

Albert Lumezi  
Kryetar i Bordit Udhëheqës

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për aksionarët e NLB Banka Sh.a.

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NLB Banka sh.a (“Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2018, dhe pasqyrën e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar dhe shënime lidhur me pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës me 31 dhjetor 2018 dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Bazat për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare, të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

#### Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe për kontrollin e brendshëm që menaxhmenti e përcakton që është i domosdoshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së bankës për të vazhduar aktivitetin, duke zbuluar, sipas rastit, çështjet që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e biznesit dhe duke përdorur bazën e vijimësisë së kontabilitetit, përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Bankën ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka alternativë tjetër, përveç se ta bëjë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Sigurimi i arsyeshëm është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë gabimet materiale kur ekzistojnë. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, ato në menyrë të arsyeshme pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me ISA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura të auditimit që i pergjigjen këtyre rreziqeve dhe marrim prova të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë fshehje, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë në përshtatshme me rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të menaxhimit të bazës së vijimësisë të kontabilitetit dhe në bazë të provave të auditimit të fituara, nëse ekziston një pasiguri materiale që lidhet me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë në shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto dhënie informacionesh shpjeguese janë jo adekuate, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në provat e auditimit të fituara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Banka të pushojë së vazhduari aktivitetin.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, ndër të tjera çështje, fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Deloitte Kosova

Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177,  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Nr. regjistrimit: 80452632  
26 shkurt 2019



Arta Limani


Partnere e angazhimit

**NLB BANKA SH.A.**  
**PASQYRA E POZITËS FINANCIARE**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018**

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>PASURITË</b>			
Paraja dhe gjendja me Bankën Qendrore	4	103,663	103,519
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	20,123	15,362
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	466,854	386,804
Pasuritë financiare të gatshme për shitje	7	64,733	65,228
Pasuritë tjera	8	800	504
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	25	-	163
Prona dhe pajisjet	9	10,870	11,399
Pasuritë e paprekshme	10	659	728
Tatimi i shtyrë	25	426	379
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>668,128</b>	<b>584,086</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrimet ndaj bankave	11	392	537
Detyrimet ndaj klientëve	12	585,851	506,672
Detyrimet tjera financiare	13	3,697	6,640
Provizionet dhe detyrimet tjera	14	6,344	3,456
Huamarrjet	16	58	77
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>596,342</b>	<b>517,382</b>
<b>EKUITETI</b>			
Kapitali aksionar	17	51,287	51,287
Rezerva e ri-vlerësuar për letrat me vlerë të gatshme për shitje	26	654	(67)
Fitimi i pashpërndarë		19,845	15,484
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>71,786</b>	<b>66,704</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti</b>		<b>668,128</b>	<b>584,086</b>


Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Udhëheqës më 26 shkurt 2018 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Mr. Albert Lumezi  
Drejtor Ekzekutiv



Mr. Bogdan Podlesnik  
Zëvendës Drejtor  
Ekzekutiv dhe Financiar



Mr. Bilall Hoti  
Drejtor i Divizionit të  
Financave

**NLB BANKA SH.A.**  
**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018**

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017
Të hyrat nga interesi dhe të ngjashme	18	30,635	27,968
Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme	19	(3,264)	(3,498)
<b>Të hyrat neto nga interesi</b>		<b>27,371</b>	<b>24,470</b>
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	20	7,827	6,772
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	21	(1,695)	(1,321)
<b>Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet</b>		<b>6,132</b>	<b>5,451</b>
Shpenzimet e provizioneve për humbjet nga kreditë	4,5,6,7	(3,742)	(1,915)
<b>Neto të hyrat operative</b>		<b>29,761</b>	<b>28,006</b>
Të hyrat tjera operative	22	375	255
Shpenzimet tjera operative	22	(1,471)	(1,094)
Provizionet tjera	15	(52)	(260)
Shpenzimet e personelit	23	(5,960)	(5,652)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	9,10	(1,179)	(1,147)
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	24	(4,661)	(4,442)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>16,813</b>	<b>15,666</b>
Tatimi në fitim	25	(1,977)	(1,469)
<b>Neto fitimi për vitin</b>		<b>14,836</b>	<b>14,197</b>
<b>Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse /(humbja):</b> <b>Zërat që ri klasifikohen në të hyrat dhe</b> <b>shpenzimet në periudhat e më vonshme</b> Neto fitimet/(humbjet) nga ndryshimi i vlerës reale të letrave me vlerë	26	182	(183)
<b>Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>15,018</b>	<b>14,014</b>
Fitimet bazë për aksion (në Euro për aksion)	27	347.5	332.5

Shënimet shpjeguese nga faqe 10 deri 77 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**NLB BANKA SH.A.**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**  
**Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018**

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Rivlerësimi i rezervës për letrat me vlerë të gatshme për shitje</b>	<b>Fitimi i mbajtur</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>51,287</b>	<b>116</b>	<b>11,441</b>	<b>62,844</b>
Dividenda e paguar	-	-	(10,154)	(10,154)
Neto fitimi për vitin	-	-	14,197	14,197
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 26)	-	(183)	-	(183)
<b>Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse/(humbja) për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(183)</b>	<b>4,043</b>	<b>3,860</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>51,287</b>	<b>(67)</b>	<b>15,484</b>	<b>66,704</b>
Efekti i ndryshimit të politikës kontabël për SNRF 9*			29	29
Dividenda e paguar	-	-	(10,504)	(10,504)
Neto fitimi për vitin	-	-	14,836	14,836
Rënia në vlerë e letrave me vlerë të gatshme për shitje	-	539	-	539
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 26)	-	182	-	182
<b>Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse/(humbjet) për vitin</b>	<b>-</b>	<b>721</b>	<b>4,361</b>	<b>5,081</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>51,287</b>	<b>654</b>	<b>19,845</b>	<b>71,786</b>

*\*Balanca hapëse është riparaqitur si rezultat i aplikimit fillestar të SNRF 9, siç është diskutuar në shënimin 2.*

Shënimet e bashkangjitura nga faqe 10 deri 77 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**NLB BANKA SH.A.**  
**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**  
**Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018**

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017
<b>Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi gjatë vitit para tatimit		<b>16,813</b>	<b>15,666</b>
Zhvlerësimi dhe amortizimi	9,10	1,179	1,147
Shpenzimet e provizioneve për humbjet nga kreditë	6	3,742	1,915
Shlyerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		33	42
Provizionet dhe humbjet e tjera	15	52	260
Të hyrat nga interesi	18	(30,635)	(27,968)
Shpenzimet e interesit	19	3,264	3,498
		<b>(5,552)</b>	<b>(5,440)</b>
Zvogëlimi në rezervën e detyrueshme me BQK	4.1	(3,310)	(2,750)
Zvogëlimi në kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	379	4,231
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	(82,229)	(59,270)
Rritja (Zvogëlimi) në pasuritë tjera		(296)	(144)
Rritja në detyrimet ndaj bankave		(145)	(802)
(Zvogëlimi)/ Rritja në detyrimet ndaj klientëve		79,179	64,576
Zvogëlimi në detyrimet tjera financiare		(2,945)	564
Rritja/ (Zvogëlimi) në detyrimet e tjera		2,902	(44)
		<b>(12,017)</b>	<b>921</b>
Interesi i arkëtuar		30,509	27,948
Interesi i paguar		(3,589)	(3,580)
Tatimi i paguar në të ardhura		(1,534)	(1,904)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>13,369</b>	<b>23,385</b>
<b>Qarkullimi i parasë nga aktivitetet investuese</b>			
Blerjet e pronës dhe pajisjeve	9	(424)	(901)
Blerjet e pasurive të paprekshme	10	(186)	(415)
Blerja e asetëve financiare të disponueshme për shitje	7	(263)	716
<b>Neto paraja e gatshme nga aktivitetet investuese</b>		<b>(873)</b>	<b>(600)</b>
<b>Qarkullimi i parasë nga aktivitetet financiare</b>			
Pagesa e huazimeve	16	(19)	(184)
Pagesa e dividendës		(10,504)	(10,154)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare</b>		<b>(10,523)</b>	<b>(10,338)</b>
<b>Rritja e parave të gatshme</b>		<b>1,973</b>	<b>12,447</b>
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 1 janar	4.1	93,724	81,277
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31 dhjetor</b>	<b>4.1</b>	<b>95,697</b>	<b>93,724</b>

Shënimet e bashkangjitura nga faqe 10 deri 77 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**NLB BANKA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TË SNRF**  
**Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018**

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

## **1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME**

NLB Banka Sh.a. është bankë komerciale (“Banka”) e regjistruar në Regjistrin e Kosovës nën Certifikatën e Regjistrimit nr. 70053484 të datës 18 dhjetor 2007. Banka është krijuar nga bashkimi i dy bankave, NLB Kasabank dhe Banka e Re e Kosovës (gjatë vitit 2007 të dy bankat ishin nën kontroll të Nova Ljubljanska Banka d.d.), dhe ka fituar licencën për aktivitete bankare më 19 dhjetor 2007 nga Banka Qendrore e Kosovës (“BQK”).

Banka kontrollohet nga Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana me qendër në Slloveni (Banka amë), e cila posedon 81.21% të aksioneve të zakonshme sipas datës 31 dhjetor 2018 (2017: 81.21% të aksioneve të zakonshme). Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana është privatizuar në vitin 2018 dhe listuar në Bursën e Londrës. 65% e Bankës tani është në pronësi të investitorëve ndërkombëtar që zotërojnë më pak se 10% secili, ndërsa Republika e Sllovenisë mbetet aksionari më i madh me 35% të aksioneve (më 31 dhjetor 2018). Republika e Sllovenisë kishte në pronësi 100% të aksioneve më 31 dhjetor 2017.

Qendra e Bankës gjendet në Rr. Ukshin Hoti nr. 124, Prishtinë, Kosovë. Banka vepron si bankë komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj me 9 degë në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Besianë, Prizren, dhe 29 nën-degë.

Banka më 31 dhjetor 2018 ka pasur 476 të punësuar (31 dhjetor 2017: 481).

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga Bordi Udhëheqës më 26 shkurt 2019.

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Banka përgatitë pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahas kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (KISNRF) dhe trupi paraprak.

Pasqyrat financiare sipas SNRF të bankës përbëhen nga pasqyrat e gjendjes financiare, pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare. Këto pasqyra financiare mbulojnë njësinë individuale, pasi që banka nuk është bankë mëmë.

### **2.2 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë, nën marrëveshjen e kostos historike siç modifikohen nga rivlerësimi i pasurive financiare të gatshme për shitje dhe asetet financiare dhe detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse ka ndonjë. Politikat kryesore kontabël janë të shpalosura më poshtë.

#### **2.2.1 Parimi i vijimësisë**

Menaxhmenti i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të vazhduar biznesin dhe operacionet e saj dhe është i kënaqur që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin e saj për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e bankës për të vazhduar aktivitetin. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë të parimit të vijimësisë.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.2 Bazat e përgatitjes për pasqyrat financiare (vazhdim)**

#### **2.2.2 Vlerësimet dhe supozimet**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në shumat e raportuara të asetëve dhe detyrimeve, dhe shpalosjen e asetëve dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit. Edhe pse këto vlerësime janë bazuar në njohuritë më të mira të ngjarjeve dhe aktiviteteve aktuale nga menaxhmenti, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara. Vlerësimet kontabël dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Vlerësimet e rëndësishme janë shpalosur në mënyrë më të detajuar në shënimin 2.21. Rishikimi i vlerësimeve njihet në mënyrë prospektive.

### **2.3 Të dhënat krahasuese**

Përveç kur një standard apo një interpretim lejon apo e kërkon ndryshe, të gjitha shumat janë raportuar ose janë shpalosur me shumat krahasuese. Aty ku është e aplikueshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'iu përshtatur ndryshimeve në paraqitjen në vitin aktual.

### **2.4 Valuta funksionale**

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është gjithashtu valuta funksionale e Bankës.

### **2.5 Të hyrat nga interesi dhe shpenzimet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjitha instrumentet që sjellin interes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të kthimit.

### **2.6 Tarifat dhe komisionet**

Të hyrat nga tarifat e komisionet dhe shpenzimet që rrjedhin nga dhënia, respektivisht përdorimi i shërbimeve bankare janë regjistruar në fitim dhe humbje siç kanë ndodhur, në momentin kur janë përfshirë shërbimet, respektivisht kur janë përdorur ato.

Tarifat e menaxhimit të kredive që ka gjasa të tërhiqen deri në fund janë shtyrë (së bashku me kostot direkt të lidhura) dhe regjistrohen si një korrigjim i normës efektive të interesit të kredisë.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga pagesat dhe komisionet përfshijnë gjithashtu pagesat nga letër garancionet dhe letërkreditë e lëshuara nga Banka në favor të klientëve, detyrimet e pagesave që rrjedhin nga bankat vendore dhe ndërkombëtare, dhe shërbimet tjera të ofruara nga Banka.

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.7 Instrumentet Financiare**

NLB Banka ka adaptuar SNRF 9 me datën 1 janar 2018, gjë që rezultoi me ndryshime në politikat kontabël për njohjen, klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare dhe zhvlerësimin e aseteve financiare.

#### **a) Klasifikimi dhe matja sipas SNRF 9**

Nga perspektiva e klasifikimit dhe matjes, SNRF 9 kërkon që të gjitha asetet financiare të borxhit të vlerësohen në bazë të një kombinimi të modelit të biznesit për menaxhimin e asetet dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të instrumenteve. Kategoritë e matjes së SNK 39 të aseteve financiare janë zëvendësuar me:

- Asetet financiare, të matura me kostot e amortizuara,
- Asetet financiare me vlerë të tregut përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse,
- Asetet financiare jo-tregtare, detyrimisht me vlerë të tregut nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Asetet financiare do të maten me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja këto dy kushte:

- Asetet financiare mbahen sipas një modeli biznesi me qëllim mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale, dhe
- Në përputhje me kontratën themelore, flukset e mjeteve monetare në datat e përcaktuara përbëhen ekskluzivisht nga pagesat e principalit dhe interesit të akumuluar në principalin e papaguar (testi SPPI është kaluar).

Asetet financiare të borxhit maten me vlerën e tregut nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse nëse të dyja këto dy kushte plotësohen:

- asetet financiare mbahen sipas një modeli biznesi me qëllim mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aseteve financiare;
- Në përputhje me kontratën themelore, flukset e mjeteve monetare në datat e përcaktuara përbëhen ekskluzivisht nga pagesat e principalit dhe interesit të akumuluar në principalin e papaguar (testi SPPI është kaluar).

Ashtu si SNK 39, SNRF 9 përfshin një opsion për të përcaktuar asetet financiare me vlerë të tregut nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse kjo e bën eliminimin ose redukton ndjeshëm një mospërputhje matjeje ose njohjeje që do të lindte nga matja e aseteve ose detyrimeve ose njohja e fitimeve ose humbjeve mbi këto baza të ndryshme.

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritur në mënyrë të arsyeshme pa marrë parasysh skenarët e "rastit më të keq" dhe "rastin e stresit". Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritjet origjinale, banka nuk ndryshon klasifikimin e aseteve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të asetit financiar të sapo origjinuar ose të sapo blerë duke ecur perpara.

Asetet financiare të përfshira në modelin e biznesit që nuk janë në gjendje të mbledhin flukset e mjeteve monetare ose të mbahen për të mbledhur flukset e mjeteve monetare dhe shitjen, gjithmonë maten me vlerën e tregut përmes pasqyrës së të ardhurave dhe nuk janë objekt i testit SPPI (p.sh. asetet financiare të mbajtura për tregti). Për më tepër, instrumentet financiare të kapitalit neto dhe instrumentet financiare që janë një kombinim i borxhit dhe kapitali neto gjithmonë maten me vlerën e tregut dhe nuk janë subjekt i testit SPPI.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.7 Instrumentet Financiare (Vazhdim)**

#### **Klasifikimi dhe matja nën SNK 39**

##### *i. Njohja fillestare*

Të gjitha asetet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht në datën e tregut, p.sh., data që Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshinë mënyrën e rregullt të tregut: blerjet apo shitjet e asetëve financiare që kërkojnë dhënien e asetit brenda kuadrit kohor të përcaktuar në përgjithësi nga rregullorja ose marrëveshja në vendin e tregut.

##### *ii. Klasifikimi*

Në njohjen fillestare, një aset financiar klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar, vlerën e tregut nëpërmjet investimeve të tjera gjithëpërfshirëse të të ardhurave, vlerën e tregut nëpërmjet investimeve të tjera të kapitalit ose vlerës së tregut nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Një aset financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

- është mbajtur brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është mbajtja e mjeteve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- janë terma kontraktuale që japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Asetet financiare në FVTPL më pas maten me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet neto, duke përfshirë të ardhurat nga interesi ose dividendët, njihen në fitim ose humbje.

Asetet financiare me koston e amortizuar më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar zvogëlohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimet dhe humbjet në valutë të huaj dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje për çregjistrim njihet në fitim ose humbje.

